



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Xhulius von Bone

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME	3
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
	A. Shqyrtimi i Aktakuzës	5
	B. Krimet dhe format e përgjegjesisë penale	6
	C. Ruajtja e konfidencialitetit.....	7
IV.	Juridiksioni	8
	A. Juridiksioni lëndor.....	9
	B. Juridiksioni kohor.....	12
	C. Juridiksioni territorial ose individual	12
V.	KRITERET LIGJORE	13
	A. Natyra dhe fushëveprimi i shqyrtimit	13
	1. Natyra e shqyrtimit	13
	2. Fushëveprimi i shqyrtimit.....	15
	B. Elementët e krimeve.....	16
	1. Kriteret kontekstuale: krimet e luftës.....	16
	2. Kriteria të veçanta: krimet të luftës	21
	C. Format e përgjegjesisë penale.....	27
	1. Kryerja e drejtpërdrejtë (neni 16(1)(a) i Ligjit)	27
	2. Ndërmarrje kriminale e përbashkët (neni 16(1)(a) i Ligjit).....	28
	3. Urdhërimi (neni 16(1)(a) i Ligjit).....	32
	4. Nxitja (neni 16(1)(a) i Ligjit).....	33
	5. Ndhurma dhe inkurajimi (neni 16(1)(a) i Ligjit)	34
	6. Përgjegjësia eprore (neni 16(1)(c) i Ligjit)	36
VI.	AKUZAT.....	39
	A. Elementët kontekstualë të krimeve të paraqitura në aktakuzë	40
	B. Krimet e paraqitura në aktakuzë	43
	1. Pika 1: Heqja arbitrare e lirisë si krim lufte.....	43
	2. Pika 2: Trajtimi mizor si krim lufte.....	46
	3. Pika 3: Tortura si krim lufte	49
	4. Pika 4: Vrasja e paligjshme si krim lufte.....	50
	C. Format e përgjegjesisë penale në aktakuzë	52
	1. Kryerja e drejtpërdrejtë.....	52
	2. Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I	53
	3. Ndërmarrje kriminale e përbashkët III	55
	4. Urdhërimi.....	56
	5. Nxitja.....	58
	6. Ndhurma dhe inkurajimi	58
	7. Përgjegjësia eprore.....	60
VII.	CILËSIMI LIGJOR I AKUZAVE.....	62
VIII.	KËRKESA PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT	63
IX.	VENDIM.....	66

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ bazuar në nenin 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr vendimin në vijim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) së bashku me materialet provuese në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat si dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

2. Më 28 shkurt 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër në të cilin i kërkonte Prokurorit të Specializuar që, ndër të tjera, të përgatiste një aktakuzë të rishikuar, ku të jepte më shumë detaje dhe qartësi në lidhje me akuzat.³ Gjykatësi i procedurës paraprake kërkoi gjithashtu që Prokurori i Specializuar të dorëzonte parashtrime më vete lidhur me (i) juridiksionin e Dhomave të Specializuara (“DHSK”) mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit, sikurse parashtrohet, ose në bazë të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976) (“Kodi Penal i RSFJ-së”) dhe (ii) elementët ligjorë të kësaj vepre penale.⁴

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të* (“Parashtrimi fillestar”), 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00003, gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores* (“Urdhër në pajtim me rregullën 86(4)”), 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 21(b).

⁴ Urdhër në pajtim me rregullën 86(4), para. 21(c).

3. Më 18 mars 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë të rishikuar, së bashku me informacione të tjera, sikurse ishte kërkuar.⁵ Një aktakuzë e rishikuar për herë të dytë u dorëzua më 20 mars 2020 (“Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë”).⁶

4. Më 26 maj 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi një urdhër ku caktohej data e synuar për lëshimin e këtij vendimi.⁷

II. PARASHTRIME

5. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) akuzon Salih Mustafën (“z. Mustafa”) për krime lufte sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jondërkombëtar.⁸ Më konkretisht, ZPS-ja pretendon se ndalimi arbitrar (Pika 1),⁹ trajtimi mizor (Pika 2),¹⁰ dhe tortura (Pika 3)¹¹ u kryen afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 në Zllash, Kosovë.¹² Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se në të njëjtën vendndodhje është kryer vrasje e paligjshme (Pika 4) afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999.¹³ Sipas ZPS-së, z. Mustafa mban përgjegjësi penale individuale sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, për kryerjen fizike, urdhërimin dhe/ose nxitjen e krimeve në Pikat 1-3 të Aktakuzës.¹⁴ Gjithashtu pretendohet se në

⁵ KSC-BC-2020-05, F00004, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesa lidhur me të* (“Parashtrimi i Dytë”), 18 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* me shtojcat 1 dhe 2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00005, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së rishikuar për herë të dytë për konfirmim* (“Parashtrimi i Tretë”), 20 mars 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1 (“Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00006, gjykatësi i procedurës paraprake, *Urdhër për caktimin e datës së synuar për marrjen e vendimit në bazë të nenit 39(2)*, 26 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 3-6, 35.

⁹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 18-20, 35.

¹⁰ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 21-28, 35.

¹¹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 29-30, 35.

¹² Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 5, 35.

¹³ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 31-33, 35.

¹⁴ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 12-13, 34.

periudhën afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999, z. Mustafa, përmes një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët (“NKP”)(në formën bazë dhe të zgjeruar)¹⁵ ka kryer dhe/ose ka ndihmuar dhe inkurajuar¹⁶ krimet e përfshira në Pikat 1-4. Si alternativë, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa mban përgjegjësi penale individuale si epror për krimet në Pikat 1-4 në bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit.¹⁷ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa është përgjegjës për krimet e luftës të përmendura më lart, të përfshira në Pikat 1-4, sipas neneve 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit, së bashku me nenet 22, 24, 26, 30, 142 dhe 145 të Kodit të RSFJ-së.¹⁸

6. ZPS-ja kërkon nga gjykatësi i procedurës paraprake që (i) të konfirmojë Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë¹⁹ dhe (ii) të lëshojë një fletarrestim, një autorizim për kontroll dhe sekuestrim dhe një urdhër transferimi.²⁰

7. Gjithashtu, ZPS kërkon mosnxjerrjen përkohësisht për publikun të Aktakuzës së Rishikuar për Herë të Dytë dhe të dokumenteve shoqëruese deri në një urdhër të mëtejshëm²¹ si dhe mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave deri sa të jenë urdhëruar masa të duhura mbrojtëse.²² ZPS-ja argumenton se ekzistojnë rreziqe reale që z. Mustafa të arratiset,²³ të ndërhyjë ndaj

¹⁵ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 8, 34. Lidhur me Pikën 4, ZPS-ja pretendon si alternativë se z. Mustafa e ka kryer krimin përmes formës së zgjeruar të ndërmarrjes kriminale të përbashkët (“NKP 3”), shih: Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 8.

¹⁶ Aktakuza e Rishikuar, para. 11, 34.

¹⁷ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para 14-17, 34.

¹⁸ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 35.

¹⁹ Parashtrimi i Tretë, para. 3.

²⁰ Parashtrimi i Tretë, para. 3. ZPS-ja përfshin përmes referimit argumentimet e paraqitura në lidhje me këto kërkesa në Parashtrimin Fillestar të saj, Pjesa B(4)-(6), shih Parashtrimi i Dytë, para. 7, 24(b).

²¹ Parashtrimi i Tretë, para. 3. ZPS-ja përfshin përmes referimit argumentimet e paraqitura në lidhje me këto kërkesa në Parashtrimin Fillestar të saj, Pjesa D, shih Parashtrimi i Dytë, para. 7-8, 24(d).

²² Parashtrimi i Tretë, para. 3. ZPS-ja përfshin përmes referimit argumentimet e paraqitura në lidhje me këto kërkesa në Parashtrimin Fillestar të saj, Pjesa C, shih Parashtrimi i Dytë, para. 7-8, 24(c).

²³ Parashtrimi Fillestar, para. 6-7.

dëshmitarëve dhe viktimave,²⁴ dhe të kryejë krime të mëtejshme²⁵ që dëshmojnë për arsye të vlefshme të cilat i përligjin këto kërkesa.

8. Për të zbatuar mosnxjerrjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave, ZPS-ja kërkon: (i) mosnxjerrjen e emrit dhe informacionit identifikues të dëshmitarëve dhe viktimave për publikun; (ii) redaktime të informacionit identifikues në materialin mbështetës dhe caktimin e pseudonimeve të përkohshme për dëshmitarët dhe viktimat e përmendur në materialin mbështetës para se ky t'i bëhet i ditur të akuzuarit ose publikut; dhe (iii) vazhdimin e mosnxjerrjes deri në një vendim të mëtejshëm pas një kërkesë të ZPS-së, apo pas dëgjimit të argumenteve të ZPS-së.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. SHQYRTIMI I AKTAKUZËS

9. Neni 39(1) dhe (2) i Ligjit dhe rregulla 86(4) e Rregullores përcaktojnë që gjykatësi i procedurës paraprake ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën. Në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe rregullës 86(4) dhe (5) të Rregullores, në qoftë se bindet se Prokurori i Specializuar ka vërtetuar ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë, gjykatësi i procedurës paraprake e konfirmon aktakuzën. Në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake nuk bindet lidhur me këtë, aktakuza ose akuzat e përfshira në të hidhen poshtë. Rregulla 86(5) e Rregullores përcakton që gjykatësi i procedurës paraprake duhet të japë një vendim të arsyetuar.

10. Në bazë të rregullës 86(3) të Rregullores, në aktakuzë duhet të jepen emri dhe të dhënat personale të të dyshuarit dhe një paraqitje e shkurtër e fakteve të çështjes

²⁴ Parashtrimi Fillestar, para. 8-11.

²⁵ Parashtrimi Fillestar, para. 12.

²⁶ Parashtrimi Fillestar, para. 21(i)-(iii).

dhe të veprës apo veprave penale për të cilat akuzohet i dyshuari, në veçanti forma e përgjegjësisë penale të pretenduar në lidhje me krimet e paraqitura në aktakuzë. Aktakuza dorëzohet së bashku me materialin mbështetës, konkretisht me materialin provues që mbështet faktet mbi të cilat bazohen krimet e paraqitura në aktakuzë, si dhe një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.

11. Pas konfirmimit të akuzës ose akuzave në aktakuzë, rregulla 86(6) e Rregullores përcakton që i dyshuari bëhet i akuzuar dhe gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë vendime ose urdhra të tjerë të paraparë në nenin 39(3) të Ligjit.

12. Rregulla 86(8) dhe (10) e Rregullores përcakton që Administratori ruan aktakuzën e konfirmuar dhe përgatit kopje të legalizuara të aktakuzës së konfirmuar me vulën e Dhomave të Specializuara dhe njofton Kryetarin për aktakuzën e konfirmuar.

B. KRIMET DHE FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

13. Përveç gjykimit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin, dispozitat e legjislacionit të Kosovës të përfshira shprehimisht në Ligj dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, nenet 3(2)(d), (3), dhe 12 të Ligjit përcaktojnë se Dhomat e Specializuara zbatojnë edhe të drejtën zakonore ndërkombëtare në fuqi në kohën e kryerjes së krimeve përkatëse. Në përcaktimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme në kohën e kryerjes së krimeve, gjykatësi mund të ndihmohet nga burime të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe burime dytësore, si jurisprudenca e tribunalëve ndërkombëtarë *ad hoc*, Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe gjykata të tjera penale.

14. Neni 14(1)(c) i Ligjit përcakton se në kuadër të këtij Ligji, sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare të zbatueshme gjatë juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara, me krime lufte në rastin e një konflikti të armatosur me karakter jondërkombëtar kuptohen shkelje të rënda të nenit 3 të përbashkët të të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 (“neni i përbashkët 3”), përfshirë edhe cilindo prej akteve në vijim të kryer kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për arsye të sëmundjes, plagëve, ndalimit, ose çfarëdo shkakut tjetër: (i) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e paligjshme të të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura; (ii) cenimi i dinjitetit personal, në veçanti trajtimet poshtëruese dhe degraduese; (iii) marrja e pengjeve, dhe (iv) shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa vendim paraprak nga një gjykatë e themeluar në mënyrë të rregullt që siguron të gjitha garancitë gjyqësore të pranuar përgjithësisht si të domosdoshme.

15. Për krimet në nenin 14 të Ligjit, neni 16(1)(a) përcakton ndër të tjera se personi i cili ka nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe ka ndihmuar dhe inkurajuar planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtij krimi, mban përgjegjësi individuale për krimin. Përveç kësaj, neni 16(1)(c) përcakton se fakti që veprimet ose mosveprimet janë kryer nga një vartës nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale, në rast se ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se vartësi kishte ndër mend t’i kryente apo i kishte kryer ato veprime dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për t’i parandaluar ato veprime, ose për t’i dënuar kryesit e tyre.

C. RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

16. Neni 39(11) i Ligjit përcakton që, kur është e nevojshme, gjykatësi i procedurës paraprake mund të sigurojë mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

17. Rregulla 85(4) e Rregullores përcakton që, varësisht prej rregullës 102 të Rregullores, të gjitha dokumentet dhe informacionet që ZPS-ja ia paraqet gjykatësit të procedurës paraprake gjatë hetimit mbeten më së paku rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

18. Rregulla 88 e Rregullores përcakton se aktakuza bëhet publike pas konfirmimit prej gjykatësit të procedurës paraprake. Megjithatë, në rrethana të veçanta, pasi janë paraqitur arsye të vlefshme, gjykatësi i procedurës paraprake mund të urdhërojë përkohësisht mosnxjerrjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose informacionit që ka lidhje me të deri në një urdhër të mëtejshëm. Sidoqoftë, aktakuza bëhet publike me redaktimet e nevojshme, jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit. ZPS-ja mund t'ua bëjë të njohur aktakuzën ose një pjesë të saj autoriteteve të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetime ose ndjekje penale.

19. Rregulla 102(1)(a) e Rregullores përcakton që ZPS-ja i vë në dispozicion të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda 30 ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit, materialet mbështetëse të aktakuzës së dorëzuar për konfirmim si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit.

20. Rregulla 105(1) e Rregullores përcakton që ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë panelit për mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të një dëshmitari ose viktime pjesëmarrëse në proces deri sa të jenë urdhëruar masat e përshtatshme mbrojtëse.

IV. JURIDIKSIONI

21. Që të konfirmohet, aktakuza duhet të plotësojë kriterin lëndor dhe kohor dhe duhet të bazohet ose në elementin territorial, ose në atë individual.

A. JURIDIKSIONI LËNDOR

22. Në nenin 6 të Ligjit përcaktohet se Dhoma e Specializuar ka juridiksion mbi krimet e përmendura në nenet 12-15 të Ligjit. Trajtimi mizor, tortura dhe vrasja e paligjshme si krime lufte të parashtruara nga Prokurori i Specializuar (Pikat 2-4), përmenden në nenin 14(1)(c)(i) të Ligjit dhe si rrjedhojë janë brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara.

23. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa ka gjithashtu përgjegjësi penale për krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), që përbën shkelje të nenit 14(1)(c) të Ligjit.²⁷ Ndonëse nuk e përmend shprehimisht ndalimin arbitrar si krim lufte në konfliktet e armatosura jondërkombëtare, kjo dispozitë nuk i kufizon krimet brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara vetëm në krimet e përmendura shprehimisht në të. Gjithsesi, që Dhomat e Specializuara të kenë juridiksion mbi një krim që nuk përmendet në nenin 14(1)(c)(i-iv) të Ligjit, një krim i tillë: (i) duhet të përbëjë shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3; dhe (ii) të ketë qenë i ndaluar prej së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimit, në pajtim me nenet 3(2)(d) dhe 12 të Ligjit.

24. Neni i përbashkët 3 përcakton se “personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët [...] ata jashtë luftimeve për shkak sëmundjeje, lëndimesh, ndalimi ose për shkaqe të tjera, trajtohen njerëzisht në çfarëdo rrethane [...]”. Kjo mbrojtje e përcaktuar gjithashtu në nenin 4(1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe në lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II) i 8 qershorit 1977, duhet të zbatohet nga të gjitha palët e konfliktit të armatosur dhe duhet t’u akordohet të gjithë personave të ndaluar, pavarësisht nga arsyet për heqjen e

²⁷ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 18-20, 35.

lirisë.²⁸ Kushti i trajtimit njerëzor përbën një detyrim themelor në të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe pasqyron të drejtën zakonore ndërkombëtare.²⁹ Ky kusht përfshin më shumë se veprimet e ndaluara të përmendura shprehimisht në nenin e përbashkët 3, të cilat janë shembuj të veprimeve që janë absolutisht në shkelje të dispozitës.³⁰

25. Heqja e lirisë pa bazë ligjore ose në shkelje të garancive bazë nuk është e pajtueshme me standardin e trajtimit njerëzor të të gjithë personave jashtë luftimit, ndër të cilët edhe personat e ndaluar, dhe është shkelje e këtij standardi të mishëruar në nenin e përbashkët 3.³¹

26. E drejta zakonore ndërkombëtare ndalon heqjen arbitrare të lirisë. Praktikrat e shumta shtetërore, ndër të tjera në formën e udhëzuesve ushtarakë, legjislacionit penal, dokumenteve të organizatave dhe konferencave ndërkombëtare dhe

²⁸ ICRC/KNKK, *Commentary on the First Geneva Convention: Convention (I) for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field*, Botim i dytë, 2016/Shpjegues i Konventës së parë të Gjenevës: Konventa (I) për përmirësimin e kushteve të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në terren (“Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 2016”) përcakton në lidhje me nenin e përbashkët 3: “është e pakontestueshme se dispozitat materiale të nenit të përbashkët 3 janë detyruese për çdo grup të tillë të armatosur që është palë në një konflikt të armatosur” (para. 508). *Shih gjithashtu* ICRC/KNKK, *Commentary on the Additional Protocols to the Geneva Conventions/Shpjegues i Protokolleve shtesë të Konventave të Gjenevës, 1987* (“Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 1987 për Protokollin Shtesë II”), lidhur me nenin 1 (para. 4460, 4470). Lidhur me nenin 5, Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 1987 për Protokollin Shtesë II sqaron se shprehja “ata të cilët janë përgjegjës për internim dhe ndalim” u referohet “personave të cilët janë përgjegjës *de facto* për kampe, burgje ose vende të tjera ndalimi, të pavarura nga cilido autoritet i njohur ligjor” (para. 4582).

²⁹ *Shih* rregullën 87, në Henckaerts J.-M., Doswald-Beck L., *Customary International Humanitarian Law* (“Studim i së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare”), Vëll. I (*Rules/Rregullat*) Cambridge University Press 2005, f. 306. *Shih gjithashtu*: ICJ/GJND, *Case Concerning the Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua (Nicaragua v. United States of America)*/Çështja në lidhje me veprimtaritë ushtarake dhe paraushtarake në Nikaragua dhe kundër saj (Nikaragua k. Shteteve të Bashkuara të Amerikës), *Merits/Bazat, Judgment of 27 June 1986/Aktgjykimi i 27 qershorit 1986*, para. 218; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tadić/Prokurori k. Tadiqit*, IT-94-1-AR72, Dhoma e Apelit, *Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction* (“Vendimi Tadiq mbi juridiksionin”), 2 tetor 1995, para. 98.

³⁰ *2016 ICRC Commentary regarding common Article 3/Shpjeguesi i KNKK-së i vitit 2016 për nenin e përbashkët 3*, para. 555; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Aleksovski/Prokurori k. Aleksovskit*, I-95-14/1, Dhoma Gjyqësore, *Judgement/Aktgjykim*, 25 qershor 1999, para. 49.

³¹ *Rule 99/Rregulla 99*, Studim i së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare, Vëll. I (*Rules/Rregullat*), f. 344.

organeve ndërkombëtare gjyqësore ose thuajse gjyqësore vërtetojnë zbatueshmërinë e kësaj mbrojtjeje në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jondërkombëtare.³² Këtë ka konfirmuar edhe KNKK-ja në rregullën 99 të Studimit të Së Drejtës Zakonore Humanitare Ndërkombëtare të vitit 2005.³³

27. Duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ndalimi arbitrar përbën shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 dhe ishte i ndaluar prej të drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën e kryerjes së krimeve të paraqitura në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë. Ligji në kontekstin shtetëror dhe ndërkombëtar ishte i qartë dhe i parashikueshëm në masë të mjaftueshme sa të mundësonte pritshmërinë e gjasës së përgjegjesisë penale individuale si pasojë e heqjes arbitrare të lirisë së një personi.³⁴

28. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake arrin në përfundimin se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi këtë krim lufte sipas nenit 14(1)(c) në kombinim me nenin 12 të Ligjit.

³² *Shih* praktikën e përmendur në *Rule 99/Rregulla 99*, Studim i së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare, Vëll. I (*Rules/Rregullat*), f. 347; Vëll. II (*Practice/Praktika*), f. 2331-2344, në veçanti f. 2331 (para. 2555), 2332 (para. 2563), 2333 (para. 2576, 2579, 2580), 2334 (para. 2593), 2335 (para 2599, 2600, 2605), 2336 (para 2606, 2607, 2608, 2611); *UN Security Council Resolutions/Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së*: 1019 (1995), U.N. Doc. S/RES/1019, 9 nëntor 1995; 1034 (1995), U.N. Doc. S/RES/1034, 21 dhjetor 1995; *UN General Assembly Resolution 50/193 (1996)/Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 50/193 (1996)*, U.N. Doc. A/RES/50/193, 11 mars 1996; *UN Commission on Human Rights/Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Situation of human rights in the Republic of Bosnia and Herzegovina, the State of Bosnia and Herzegovina, the Republic of Croatia and the Federal Republic of Yugoslavia (Serbia and Montenegro)/Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës, shtetin e Bosnjë-Hercegovinës, Republikën e Kroacisë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi)*, U.N. Doc. E/CN.4/RES/1996/71, 23 prill 1996; *UN Commission on Human Rights/Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Situation of human rights in the Sudan/Gjendja e të drejtave të njeriut në Sudan*, U.N. Doc. E/CN.4/RES/1996/73, 23 prill 1996, para. 15. *Shih gjithashtu* nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së.

³³ *Rule 99/Rregulla 99*, Studim i së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare, Vëll. I (*Rules/Rregullat*), f. 344.

³⁴ *Shih gjithashtu* nenin 142 të Kodit të RSFJ-së.

B. JURIDIKSIONI KOHOR

29. Neni 7 i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krimet brenda juridiksionit të tyre lëndor të cilat ndodhën midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000. Meqenëse Prokurori i Specializuar pretendon se krimet e Pikave 1-3 u kryen afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 dhe krimi i Pikës 4 u krye afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999,³⁵ gjykatësi i procedurës paraprake arrin në përfundimin se krimet janë brenda juridiksionit kohor të Dhomave të Specializuara.

C. JURIDIKSIONI TERRITORIAL OSE INDIVIDUAL

30. Në bazë të nenit 8 të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion mbi krime brenda juridiksionit të tyre lëndor të cilat kanë filluar të kryhen ose janë kryer në Kosovë. Në bazë të nenit 9(2) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë juridiksion individual kur të dyshuarit janë individë me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ") (parimi i personalitetit aktiv) ose krimet janë kryer kundër personave me shtetësi të Kosovës/RFJ-së (parimi i personalitetit pasiv), kudo që të jenë kryer ato. Elementi territorial dhe individual janë alternativa të njëri-tjetrit. Përmbushja e njërit prej këtyre kriterëve është e mjaftueshme për të bërë konstatim konfirmues në lidhje me juridiksionin.

31. Krimet e pretenduara prej Prokurorit të Specializuar ndodhën në Zllash, Kosovë.³⁶ Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se është përmbushur kriteri i juridiksionit territorial sipas nenit 8 të Ligjit.

32. Duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake arrin në përfundimin se çështja është brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

³⁵ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 35; [E REDAKTUAR].

³⁶ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 5; [E REDAKTUAR].

V. KRITERET LIGJORE

A. NATYRA DHE FUSHËVEPRIMI I SHQYRTIMIT

1. Natyra e shqyrtimit

33. Konfirmimi i aktakuzës është një proces *ex parte* pa përfshirjen e Mbrojtjes. Shqyrtimi në procedurë paraprake siguron që në gjykim të shqyrtohen vetëm ato akuza për të cilat janë paraqitur prova të mjaftueshme. Gjithashtu ai siguron që aktakuza t'i japë të akuzuarit informacion të mjaftueshëm për të kuptuar qartë dhe plotësisht natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij, me qëllim përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate.³⁷

34. Në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(1) të Rregullores, Prokurori i Specializuar dorëzon aktakuzën së bashku me materialin mbështetës për t'u shqyrtuar prej gjykatësit të procedurës paraprake. Gjatë procesit të shqyrtimit, gjykatësi i procedurës paraprake u përmbahet kushteve të rregullës 86(3) të Rregullores, në veçanti ekzistencës së informacionit të mjaftueshëm për sa i përket emrit dhe të dhënave personale të të akuzuarit, paraqitjes së fakteve dhe paraqitjes së krimeve,³⁸ dhe nëse është nevoja e kthimit tek Prokurori i Specializuar, në bazë të rregullës 86(4)(a)-(c) të Rregullores. Në veçanti, gjykatësi i procedurës paraprake mund t'i kërkojë ose t'i lejojë Prokurorit të Specializuar të paraqesë materiale shtesë në mbështetje të ndonjë prej akuzave ose të të gjitha akuzave. Në vijim, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit dhe përcaktimeve të përgjithshme të rregullës 86(4) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake shqyrton

³⁷ Urdhër në pajtim me rregullën 86(4), para. 9.

³⁸ Në lidhje me këtë, gjykatësi i procedurës paraprake duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur të drejtave të akuzuarit të parapara në nenin 21(4)(a), (c) dhe (d) të Ligjit që janë pasqyrim i neneve 6(1), (3)(a) dhe (b) të Konventës (Evropiane) për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe i nenit 14(3)(a), (b) dhe (c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

materialin mbështetës në lidhje me secilën prej akuzave në aktakuzë për të përcaktuar nëse ZPS-ja ka vërtetuar një dyshim të bazuar mirë se i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

35. Ndonëse as Ligji e as Rregullorja nuk e përkufizojnë dyshimin e bazuar mirë, bëhet diferencim i qartë i këtij standardi prej standardeve të tjera të provave që parashihen në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Ligji parasheh katër standarde provash me përshkallëzim progresiv: (i) arsye për të besuar (në nenin 38(3)(a) të Ligjit, lidhur me statusin e të dyshuarve); (ii) dyshim i bazuar (në nenin 41(6) të Ligjit, lidhur me fletarrestimet e Dhomave të Specializuara ose urdhërarrestimet e ZPS-së); (iii) dyshim i bazuar mirë (në nenin 39(3) të Ligjit dhe rregullën 86(4) të Rregullores, lidhur me konfirmimin e një aktakuze); dhe (iv) jashtë dyshimit të arsyeshëm (në nenin 21(3) të Ligjit dhe rregullën 158(3) të Rregullores, lidhur me vendimet e fajësisë). Për fillimin e procedimit kundër një të akuzuari, standardi i dyshimit të bazuar mirë është domosdoshmërisht më i lartë se sa standardet e kërkuara për përcaktimin se cilët janë të dyshuarit dhe për urdhërimin e arrestimeve, si dhe është qartësisht më i ulët se sa standardi i vendimit të fajësisë pas zhvillimit të gjykimit.

36. Gjykatësi i procedurës paraprake vëren se në bazë të nenit 19.1.12 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës 2012, ("KPP"), dyshimi i bazuar mirë arrihet kur provat "do të bindnin një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri".³⁹ Në veçanti, nuk është e mjaftueshme, sikurse kërkohet në lidhje me dyshimin e bazuar sipas nenit 19.1.9

³⁹ Termi "objektiv" përkufizohet (në anglishte) si "që nuk ndikohet nga ndjenjat dhe mendimet vetjake në shqyrtimin dhe përshkrimin e fakteve", shih *OED Online* (Oxford University Press, dhjetor 2019), gjendet në <https://www.oed.com/view/Entry/129634?redirectedFrom=objective#eid> (parë për herë të fundit më 19 mars 2020).

të KPP-së, që vëzhguesi objektiv të bindet që “ka më shumë gjasa që personi në fjalë të ketë kryer veprën penale se sa të mos e ketë kryer”.

37. Rrjedhimisht, ndonëse më i ulët se standardi i qartësisë së një fakti të vërtetuar, përcaktimi i ekzistencës së dyshimit të bazuar mirë gjithsesi kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake të bindet, përtej teorisë apo dyshimit të thjeshtë se, (i) elementët kontekstualë të krimit (nëse është kryer krim) janë të pranishëm; (ii) aktet ose krimet bazë kanë ndodhur me të vërtetë; dhe (iii) i dyshuari ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimit përmes formës ose formave të pretenduara të përgjegjësisë penale. Gjykatësi i procedurës paraprake i bazon këto konstatime në material mbështetës konkret dhe të qartë, i cili demonstroi një linjë të qartë arsyetimi mbi të cilën bazohen akuzat në aktakuzë. Duke bërë këtë, gjykatësi i procedurës paraprake e vlerëson materialin mbështetës në tërësinë e tij, pa bërë shqyrtim të imtë të secilës prej provave.⁴⁰

2. Fushëveprimi i shqyrtimit

38. Në bazë të rregullës 86(4) të Rregullores, për të përcaktuar nëse ekziston dyshimi i bazuar mirë, gjykatësi i procedurës paraprake shqyrton vetëm aktakuzën, përmbledhjen e detajuar dhe materialin mbështetës, pa marrë parasysh informacione apo materiale të tjera jothelbësore, edhe nëse këto janë të disponueshme publikisht. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake mund ta konfirmojë ose hedhë poshtë aktakuzën vetëm mbi bazën e informacionit dhe materialit provues të dorëzuar nga ZPS-ja.⁴¹

⁴⁰ Në mënyrë të ngjashme, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga/Prokurori k. Lubangas*, ICC-01/04-01/06-803-tEN, Dhoma e Procedurës Paraprake I, *Decision on the Confirmation of Charges/Vendim mbi konfirmimin e akuzave*, 29 janar 2007, para. 39; *Prosecutor v. Gbagbo/Prokurori k. Gbagbos*, ICC-02/11-01/11-656-Red, Dhoma e Procedurës Paraprake I, *Decision on the Confirmation of Charges Against Laurent Gbagbo/Vendim mbi konfirmimin e akuzave kundër Laurent Gbagbos*, 12 qershor 2014, para. 22.

⁴¹ Në mënyrë të ngjashme, STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al./Prokurori k. Ajashit dhe të tjerëve*, STL-17-07/I/AC/R176bis, Dhoma e Apelit, *Interlocutory Decision on the Applicable Law: Criminal Association and*

39. Si pjesë e procesit të shqyrtimit, për përcaktimin e pranueshmërisë dhe rëndësisë së provave sikurse parashihet në rregullat 137-139 të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake kryen një vlerësim paraprak të materialit mbështetës, pa ndërhyrë në kompetencat e trupit gjykues.⁴² Pavarësisht nga kjo, gjykatësi i procedurës paraprake nuk do të mbështetet në material që është qartësisht (i) joautentik ose (ii) është siguruar nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit, Rregullores, ose standardeve të së drejtës së të drejtave të njeriut, ose me anë të torturës apo çfarëdo forme të trajtimit çnjerëzor apo poshtërues, sikurse parashihet në rregullën 138(2)-(3) të Rregullores.

B. ELEMENTËT E KRIMEVE

1. Kriteret kontekstuale: krimet e luftës

40. Kriteret kontekstuale për krimet e luftës të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur me karakter jondërkombëtar përbëhen nga: (i) ekzistenca e një konflikti të armatosur të një farë intensiteti në territorin e një shteti, ndërmjet organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla; (ii) lidhja ndërmjet shkeljes bazë dhe konfliktit të armatosur, dhe (iii) dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur.

Review of the Indictment/Vendim i ndërmjetëm lidhur me dispozitat ligjore përkatëse: bashkëpunimi kriminal dhe shqyrtim i aktakuzës, 18 tetor 2017, para. 111.

⁴² Në mënyrë të ngjashme, *STL/TSL, Prosecutor v. Ayyash et al.* /Prokurori k. Ajashit dhe të tjerëve, STL-11-01/I, gjykatësi i procedurës paraprake, *Decision Relating to the Examination of the Indictment of 10 June 2011 Issued Against Mr Salim Jamil Ayyash, Mr Mustafa Badreddine, Mr Hussein Hassan Oneissi & Mr Assad Hassan Sabra*/Vendim lidhur me shqyrtimin e Aktakuzës së 10 qershorit 2011 kundër z. Salim Xhamil Ajash, z. Mustafa Badredin, z. Husein Hasan Oneisi dhe z. Asad Hasan Sabra, 28 qershor 2011, para. 26.

(a) Ekzistenca e konfliktit të armatosur

41. Neni 14(2) i Ligjit përcakton se konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar ndodhin në territorin e një shteti kur ekziston një konflikt i armatosur i zgjatur mes organeve të pushtetit dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose mes grupeve të tilla.⁴³

42. Konfliktet e armatosura karakterizohen nga shpërthimi i luftimeve që ndodhin në territorin e një shteti.

43. Në lidhje me palët në luftime, neni 14(2) i Ligjit përmend dy kategori të palëve të mundshme në konflikt të armatosur që duhet të interpretohen në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare. “Organe të pushtetit” përfshijnë autoritetet qeveritare, si forcat e rregullta të armatosura, njësitë e policisë, gardat kombëtare ose autoritete të tjera të një natyre të ngjashme,⁴⁴ ndër të cilat edhe grupet e armatosura dhe forca të mbrojtjes territoriale të përfshira në forcat e armatosura.⁴⁵ Termi “grupe të armatosura të organizuara” nënkupton një shkallë organizimi, por “jo domosdoshmërisht duhet të jenë po aq të organizuara sa forcat e armatosura të një shteti”.⁴⁶ Nuk është e nevojshme që ato të kryejnë operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të bashkërenduara, por duhet të jenë

⁴³ ICTY/TPNJ, *Tadić Decision on Jurisdiction/Vendimi Tadiq mbi Juridiksionin*, para. 70; *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski”), 19 maj 2010, para. 21. *Shih gjithashtu ICC/GJPN, Prosecutor v. Ntaganda/Prokurori k. Ntagandas*, ICC-01/04-02/06-2359, Dhoma Gjyqësore VI, *Judgment* (“Aktgjykimi Ntaganda”), 8 korrik 2019, para. 701; *Prosecutor v. Lubanga/Prokurori k. Lubangas*, ICC-01/04-01/06-2842, Dhoma Gjyqësore I, *Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute* (“Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore Lubanga”), 14 mars 2012, para. 533.

⁴⁴ ICTY/TPNJ, *Prokurori k. Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-T, *Judgement* (“Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski”), 10 korrik 2008, para. 178, 195.

⁴⁵ Neni 43(3) i Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe në Lidhje me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokollin I), i 8 qershorit 1977.

⁴⁶ ICTY/TPNJ, *Bošković and Tarčulovski Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 195, 197; *Prosecutor v. Orić/Prokurori k. Oriqit*, IT-03-68-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Oriq”), 30 qershor 2006, para. 254; *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Haradinajt”), 3 prill 2008, para. 60; *Prokurori k. Limaj dhe të tjerëve*, IT-03-66-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë”), 30 nëntor 2005, para. 89.

mjaftueshmërisht të organizuara për t'u përballur me njëra-tjetrën me mjete ushtarake.⁴⁷ Në përcaktimin nëse një entitet joshtetëror mund të kryejë dhunë të armatosur për një kohë të zgjatur, mund të merren parasysh faktorët tregues të mëposhtëm: (i) ekzistenca e një strukture komanduese, ku përfshihen ekzistenca e një selie të shtabit, e një shtabi të përgjithshëm ose komande të lartë, e gradave dhe posteve të identifikueshme, dhe e një rregulloreje të brendshme; (ii) lëshimi i deklaratave politike ose komunikatave dhe përdorimi i zëdhënësve; (iii) kapaciteti operativ dhe aftësia për kryerjen e operacioneve ushtarake; (iv) kapaciteti logjistik që përfshin disponueshmërinë e armëve dhe pajisjeve dhe kapaciteti për të lëvizur trupat dhe për të rekrutuar dhe stërvitur personelin; (v) kontrolli territorial që përfshin ndarjen në zona të përgjegjësive; (vi) sistemi i brendshëm disiplinor që përfshin zbatimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare në radhët e grupit të armatosur; (vii) aftësia për të folur me një zë të vetëm në emër të grupit të armatosur, për shembull në negociata politike apo marrëveshje armëpushimi.⁴⁸

44. Në lidhje me nivelin e intensitetit të konfliktit, neni 14(2) i Ligjit kërkon që luftimet ndërmjet palëve duhet të arrijnë një shkallë të caktuar intensiteti që shkon përtej prishjes së rendit dhe tensioneve të brendshme, siç janë trazirat, veprimet e izoluara apo sporadike të dhunës apo veprime të tjera të një natyre të ngjashme. Në këtë kontekst, nocioni i “dhunës së armatosur të zgjatur” shërben për përkufizimin e standardit të intensitetit sepse i referohet “më tepër intensitetit të

⁴⁷ ICTY/TPNJ, *Bošković and Tarčulovski Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski* para. 197-198.

⁴⁸ *Shih gjithashtu* neni 1(1) i Protokollit shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Jondërkombëtare (Protokolli II) i 8 qershorit 1977. (“Protokolli Shtesë II”). *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, *Bošković and Tarčulovski Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 194-203. Megjithatë, shkalla e organizimit të një grupi të armatosur në një konflikt për të cilin është i zbatueshëm neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës, nuk është e nevojshme të jetë në nivelin organizimit që kërkohet për palët në konfliktet e armatosura për të cilat është i zbatueshëm Protokolli Shtesë II, shih ICTY/TPNJ, *Bošković and Tarčulovski Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 197.

dhunës së armatosur se sa kohëzgjatjes së saj”.⁴⁹ Intensiteti mund të deduktohet, për shembull nga (i) ashpërsia dhe shpeshhtësia e sulmeve; (ii) përhapja e tyre në hapësirën territoriale dhe gjatë një periudhe kohe, dhe nëse janë lëshuar urdhra armëpushimi; (iii) shtimi dhe numri i forcave të dislokuara; (iv) mobilizimi dhe shpërndarja e armëve ndër palët në konflikt; (v) lloji i armëve të përdorura, në veçanti përdorimi i artilerisë së rëndë; (vi) përdorimi i mjeteve luftarake, në veçanti përdorimi i tankeve; (vii) nëse situata ka tërhequr vëmendjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave të tjera ndërkombëtare; (viii) ndikimet në popullatën civile, shkalla e shkatërrimit dhe numri i personave të vrarë ose të zhvendosur; dhe (ix) mënyra në të cilën është trajtuar grupi i armatosur nga të tjerët dhe cilat janë ligjet sipas të cilave pretendon se ka vepruar.⁵⁰

45. Së fundi, shtrirja kohore dhe gjeografike e konflikteve të armatosura me karakter jondërkombëtar i kapërcen kufijtë e kohës dhe vendit të saktë të luftimeve; rregullat e zbatueshme veprojnë përtej pushimit të luftimeve deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore.⁵¹ Rrjedhimisht, normat e së drejtës humanitare ndërkombëtare janë të zbatueshme pavarësisht nëse faktikisht po ndodhin

⁴⁹ ICTY/TPNJ, *Haradinaj Trial Judgment/Aktgjykimi Haradinaj*, para. 49; *Shih gjithashtu Prosecutor v. Kordić and Čerkez/Prokurori k. Kordiqit dhe Çerkezit*, IT-95-14-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Çerkez”), 17 dhjetor 2004, para. 341; *Prosecutor v. Tadić/Prokurori k. Tadiqit*, IT-94-1-T, Dhoma Gjyqësore, *Opinion and Judgment*, 7 maj 1997, para. 562.

⁵⁰ ICTY/TPNJ, *Boškoski and Tarčulovski Trial Judgment/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 177, konfirmuar nga *Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski* para. 22 dhe 24; ICC/GJPN, *Ntaganda Trial Judgment/Aktgjykimi Ntaganda*, para. 703-704, 716; *Prosecutor v. Bemba/Prokurori k. Bembas*, ICC-01/05-01/08-3343, Dhoma Gjyqësore III, *Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute/Aktgjykim në bazë të nenit 74 të Statutit* (“Aktgjykimi Bemba”), 21 mars 2016, para. 137; *Lubanga Trial Judgment/Aktgjykimi Lubanga*, para. 538; *Prosecutor v. Katanga/Prokurori k. Katangas*, ICC-01/04-01/07-3436-tENG, Dhoma Gjyqësore II, *Judgment Pursuant to Article 74 of the Statute/Aktgjykim në bazë të nenit 74 të Statutit* (“Aktgjykimi Katanga”), 7 mars 2014, para. 1186-1187.

⁵¹ ICTY/TPNJ, *Tadić Decision on Jurisdiction/Vendimi Tadiq mbi Juridiksionin*, para. 67-70; *Limaj et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë*, para. 84; *Prosecutor v. Vasiljević/Prokurori k. Vasileviqit*, IT-98-32-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgment/Aktgjykim*, 29 nëntor 2002, para. 25; *Prosecutor v. Kunarac et al./Prokurori k. Kunaracit dhe të tjerëve*, IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerë”), 12 qershor 2002, para. 57.

veprimtari luftarake në një vendndodhje të caktuar.⁵² Në rastin e personave të cilëve u është kufizuar liria, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet deri në momentin kur përfundon heqja apo kufizimi i lirisë.⁵³

(b) Lidhja me konfliktin e armatosur

46. Krimet e pretenduara duhet të kenë lidhje të mjaftueshme me konfliktin e armatosur. Nuk është e nevojshme që konflikti i armatosur të ketë shkaktuar kryerjen e krimit për të cilin është ngritur akuzë, por ai duhet të ketë luajtur, më së paku një rol të konsiderueshëm në aftësinë e kryesit për ta kryer atë krim, vendimin e tij për ta kryer atë, mënyrën se si u krye krimi, ose qëllimin për të cilin u krye ai.⁵⁴ Në përcaktimin e ekzistencës së lidhjes duhet t'i kushtohet vëmendje: (i) statusit të kryesit dhe të viktimës; (ii) nëse akti i shërben qëllimit përfundimtar të fushatës ushtarake; ose (iii) nëse akti u krye si pjesë e, apo në kontekstin e detyrave zyrtare të kryesit.⁵⁵

⁵² ICTY/TPNJ, *Orić* Trial Judgment/Aktgjykimi *Orić*, para. 255; *Tadić* Decision on Jurisdiction/Vendimi *Tadić* mbi Juridiksionin, para. 70.

⁵³ 1987 ICRC *Commentary to Additional Protocol II regarding Article 2(2)*/Shpjegues i KNKK-së i vitit 1987 për Protokollin Shtesë II lidhur me nenin 2(2), para. 4491-4496.

⁵⁴ ICTY/TPNJ, *Kunarac et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 58; *Prosecutor v. Stakić*/Prokurori k. Stakiqit, IT-97-24-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Stakić*"), 22 mars 2006, para. 342; *Tadić* Decision on Jurisdiction/Vendimi *Tadić* mbi Juridiksionin para. 70; ICTR/TPNR, *Setako v. Prosecutor/Setako* k. Prokurorit, ICTR-04-81-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Setako*"), 28 shtator 2011, para. 249; *Rutaganda v. Prosecutor/Rutaganda* k. Prokurorit, ICTR-96-3-A, Dhoma e Apelit, *Judgement*/Aktgjykimi i Apelit, 26 maj 2003, para. 569-570.

⁵⁵ ICTY/TPNJ, *Kunarac et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 59; ICC/GJPN, *Bemba* Trial Judgment/Aktgjykimi *Bemba*, para. 143.

(c) Dijenia për ekzistencën e konfliktit të armatosur

47. Kryesi duhet të ketë dijeni për rrethanat faktike që përcaktojnë konfliktin e armatosur me karakter jondërkombëtar.⁵⁶ Nuk është e nevojshme që kryesi të ketë njohuri për klasifikimin e saktë ligjor të konfliktit të armatosur.⁵⁷

2. Kritere të veçanta: krime të luftës

48. Të gjitha krimet duhet të kryhen kundër personave të mbrojtur. Pjesa e përgjithshme e nenit 14(1)(c) të Ligjit që përmend nenin e përbashkët 3(1) kërkon që viktima të mos ketë qenë duke marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e kryerjes së veprës penale.⁵⁸ Pjesëmarrja aktive në luftime nënkupton kryerjen e akteve si pjesë e zhvillimit të luftimeve të cilat për nga natyre ose qëllimi synojnë t'i shkaktojnë dëmtim faktik personelit ose pajisjeve të palës kundërshtare.⁵⁹ Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, ndër të cilët edhe anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit, apo çfarëdo shkak tjetër, janë të mbrojtur

⁵⁶ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*/Prokurori k. Naletiliqit dhe Martinoviqit, IT-98-34-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Martinoviq"), 3 maj 2006, para. 118-121; *Boškoski and Tarčulovski Trial Judgment*/Aktgjykimi Boshkoski dhe Tarçulovski, para. 295. *Shih gjithashtu ICC/GJPN, Ntaganda Trial Judgment*/Aktgjykimi Ntaganda, para. 698.

⁵⁷ ICTY/TPNJ, *Naletilić and Martinović Appeal Judgment*/Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Martinoviq para. 119; *Kordić and Čerkez Appeal Judgment*/Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Čerkez, para. 311.

⁵⁸ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.9, Dhoma e Apelit, *Decision on Appeal from Denial of Judgment of Acquittal for Hostage-Taking* ("Vendimi Karaxhiq i 11 dhjetorit 2012"), 11 dhjetor 2012, para. 8, 21; IT-95-5/18-AR72.5, Dhoma e Apelit, *Decision on Appeal of Trial Chamber's Decision on Preliminary Motion to Dismiss Count 11 of the Indictment*/Vendim mbi apelimin e vendimit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me mocionin paraprak për rrëzimin e pikës 11 të aktakuzës, 9 korrik 2009, para. 22-26; *Boškoski and Tarčulovski Appeal Judgment*/Aktgjykimi i Apelit Boshkoski dhe Tarçulovski, para. 66; *Prosecutor v. Strugar*/Prokurori k. Strugarit, IT-01-42-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Strugar"), 17 korrik 2008, para. 172, 178; *Prosecutor v. Mucić et al.*/Prokurori k. Muciqit dhe të tjerëve, IT-96-21-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Muciq dhe të tjerë"), 20 shkurt 2001, para. 420, 424.

⁵⁹ ICTY/TPNJ, *Strugar Appeal Judgment*/Aktgjykimi i Apelit Strugar, para. 178; ICC/GJPN, *Katanga Trial Judgment*/Aktgjykimi Katanga, para. 789-790. *Shih gjithashtu nenin 13(3) të Protokollit Shtesë II.*

sipas nenit të përbashkët 3. Kryesi duhet të dijë ose duhej të kishte ditur për statusin e viktimave si persona që nuk marrin pjesë aktive në luftime.⁶⁰

(a) Ndalimi arbitrar

Elementët materialë (veprimi i fajshëm)

49. Krimi i ndalimit arbitrar si krim lufte, sipas përcaktimit të nenit 14(1)(c) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi që sjell si pasojë heqjen e lirisë së një personi i cili nuk merr pjesë aktive në luftime, pa bazë ligjore dhe pa përmbushur garancitë procedurale bazë.

50. Heqja e lirisë është pa bazë ligjore nëse nuk përlijet as prej një procesi penal dhe as prej arsyeve për të besuar se heqja e lirisë është absolutisht e domosdoshme për arsye të sigurisë.⁶¹

51. Garancitë procedurale bazë përfshijnë, në veçanti (i) detyrimin për ta informuar personin e arrestuar për arsyet e arrestimit; (ii) detyrimin për ta nxjerrë personin e arrestuar mbi bazën e një akuze penale menjëherë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent; dhe (iii) detyrimin për t'i dhënë personit të cilit i është hequr liria mundësinë të bëjë ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tij.⁶²

⁶⁰ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Mladić*/Prokurori k. Mladiqit, IT-09-92-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgment* (“Aktgjykimi Mlladiq”), 22 nëntor 2017, para. 3017; *Karadžić* Decision 11 December 2012/Vendimi *Karaxhiq* i 11 dhjetorit 2012, para. 22; *Bošković and Tarčulovski* Appeal Judgment /Aktgjykimi i Apelit *Boshkoski dhe Tarçulovski*, para. 66.

⁶¹ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Muciq dhe të tjerë*, para. 320-322; *Kordić and Čerkez* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 72-73; Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Co-Prosecutors v. Kaing Guek Eav/Prokurorët k. Kaing Guek Eav*, 001/18-07-2007/ECCC/TC, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Duch”), 26 korrik 2010, para. 465.

⁶² *Rule 99/Rregulla 99*, Studim i së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare, Vëll. I (*Rules/Rregullat*), f. 349-350. *Shih gjithashtu* nenin 6, Protokolli Shtesë II.

52. Në kryerjen e vlerësimit nëse janë përmbushur garancitë procedurale bazë, nuk ka rëndësi nëse (i) heqja e lirisë ishte fillimisht e përligjur⁶³ ose (ii) kryesi është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të drejtave procedurale të të ndaluarit.⁶⁴

Elementi mendor (synimi kriminal)

53. Sjellja e kryesit duhet të jetë e qëllimshme. Përveç kësaj, kryesi nuk duhet të ketë arsye për të besuar se ndalimi është absolutisht i domosdoshëm për shkak të shqetësimeve të palëve në konflikt për sigurinë, ose kryesi duhet të dijë se të ndaluarve nuk u janë akorduar garancitë e duhura procedurale, ose të tregohet qëllimisht shpërfillës nëse janë akorduar këto garanci apo jo.⁶⁵

(b) Trajtimi mizor

Elementët materialë (veprimi i fajshëm)

54. Krimi i trajtimit mizor si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet përmes një veprimi ose mosveprimi që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose që përbën një cenim të rëndë të dinjitetit njerëzor.⁶⁶

55. Shkalla e rëndësisë së dëmit ose lëndimit duhet vlerësuar rast pas rasti, duke marrë parasysh faktorë si: (i) ashpërsia e sjelljes së pretenduar; (ii) natyra e veprimit ose mosveprimit; (iii) konteksti në të cilin ka ndodhur sjellja;

⁶³ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Muciq dhe të tjerë*, para. 322. *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, *Kordić and Čerkez* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, para. 73; Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch* Trial Judgment/Aktgjykimi *Duch*, para. 465.

⁶⁴ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Muciq dhe të tjerë*, para. 379.

⁶⁵ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Muciq dhe të tjerë*, para. 378.

⁶⁶ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Muciq dhe të tjerë*, para. 424. *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Haradinaj*”), 19 korrik 2010, para. 93-94; *Prosecutor v. Blaškić*/Prokurori k. Bllashkiqit, IT-95-14-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*”), 29 korrik 2004, para. 595.

(iv) kohëzgjatja dhe/ose përsëritja e sjelljes; (v) ndikimi fizik dhe mendor i sjelljes mbi viktimën; dhe (vi) rrethanat personale të viktimës, ndër të cilat moshë, gjinia dhe gjendja shëndetësore.⁶⁷

56. Vuajtja e shkaktuar nga veprimi mbi viktimën nuk është e nevojshme të jetë afatgjatë, për sa kohë që është e vërtetë dhe e rëndë.⁶⁸

Elementi mendor (synimi kriminal)

57. Kryesi duhet të ketë vepruar në mënyrë të qëllimshme ose me dijeninë se vuajtja apo lëndimi i rëndë mendor ose fizik, ose cenimi i rëndë i dinjitetit njerëzor, ishte pasojë e mundshme e veprimit ose mosveprimit.⁶⁹

(c) Tortura

Elementët materialë (veprimi i fajshëm)

58. Krimi i torturës si krim lufte brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që shkakton dhembje ose vuajtje të rëndë, qoftë fizike apo mendore, mbi një person tjetër.⁷⁰ Nëse veprimi apo

⁶⁷ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Popović et al.* /Prokurori k. Popovićit dhe të tjerëve, IT-05-88-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Popović dhe të tjerë”), 10 qershor 2010, poshtëshënimi 3249; *Prosecutor v. Kvočka et al.* /Prokurori k. Kvočkës dhe të tjerëve, IT-98-30/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerë”), 28 shkurt 2005, para. 584-585; *Prosecutor v. Mrkšić et al.*/Prokurori k. Mrkshiqit dhe të tjerëve, IT-95-13/1-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Mrkshiq dhe të tjerë”), 27 shtator 2007, para. 516, 525, 537; *Prosecutor v. Krnojelac*/Prokurori k. Krnojellacit, IT-97-25-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgment* (“Aktgjykimi Krnojellac”), 15 mars 2002, para. 131.

⁶⁸ ICTY/TPNJ, *Krnojelac Trial Judgment/Aktgjykimi Krnojellac*, para. 131.

⁶⁹ ICTY/TPNJ, *Popović et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Popović dhe të tjerë*, para. 974; *Mrkšić et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Mrkshiq dhe të tjerë*, para. 516; *Limaj et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë*, para. 231; *Prosecutor v. Strugar*/Prokurori k. Strugarit, IT-01-42-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement/Aktgjykimi Strugar*, 31 janar 2005, para. 261.

⁷⁰ ICTY/TPNJ, *Haradinaj Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Haradinaj*, para. 290; *Kunarac et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerë*, para. 142. *Shih gjithashtu ICC/GJPN, Prosecutor v. Bemba*/Prokurori k. Bembas, ICC-01/05-01/08-424, Dhoma e Procedurës Paraprake II, *Decision Pursuant to Article 61(7)(a) and (b) of the Rome Statute on the Charges of the Prosecutor Against Jean-Pierre Gombo*, 15 qershor 2009, para. 292; *Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 354.

mosveprimi i përmbush kriteret e aktit të torturës duhet të shqyrtohet rast pas rasti,⁷¹ duke marrë parasysh, për shembull (i) natyrën dhe rrethanat e shkaktimit të dhembjes; (ii) paramendimin dhe institucionalizimin e keqtrajtimit; (iii) gjendjen fizike të viktimës; (iv) mënyrën dhe metodën e përdorur; (v) pozitën inferiore të viktimës; (vi) shkallën në të cilën është keqtrajtuar individi gjatë një periudhe të zgjatur kohe; (vii) përdorimin e formave të përsëritura ose të ndryshme të keqtrajtimit që janë të ndërlidhura, kryhen sipas një praktike të caktuar sjelljeje, ose bëhen për arritjen e të njëjtit qëllim të ndaluar.⁷² Kushtet e imponuara gjatë ndalimit, si rrahjet, dhuna seksuale, mohimi për një kohë të gjatë i gjumit, ushqimit, higjienës dhe ndihmës mjekësore, si dhe kërcënimet me torturë, përdhunim, ose vrasje të të afërmeve, janë konsideruar mjaftueshmërisht të rënda sa të përbëjnë torturë.⁷³

59. Nuk është e nevojshme që pasojat e veprimit ose mosveprimit të jenë të dukshme tek viktima që të përbëjnë torturë dhe as nuk është kusht që lëndimi të jetë i përhershëm.⁷⁴ Nuk është kusht që kryesi të ketë vepruar në cilësinë e një zyrtari publik apo të një personi me pozitë eprore.⁷⁵

⁷¹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Brđanin/Prokurori k. Brgjaninit*, IT-99-36-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit Brgjanin”), 3 prill 2007, para. 251; *Naletilić and Martinović Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Martinović*, para. 299; *Kunarac et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerë*, para. 149.

⁷² ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Simić et al./Prokurori k. Simiqit dhe të tjerëve*, IT-95-9-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Simiq dhe të tjerë”), 17 tetor 2003, para. 80, që i referohet *Krnojelac Trial Judgment/Aktgjykimi Krnojelac*, para. 182. *Shih gjithashtu* Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 355.

⁷³ Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 355, që i referohet ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Mucić et al./Prokurori k. Muciqit dhe të tjerëve*, IT-96-21-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Muciq dhe të tjerë”), 16 nëntor 1998, para. 467; *Prosecutor v. Kvočka et al./Prokurori k. Kvočkës dhe të tjerëve*, IT-98-30/1-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi Kvočka dhe të tjerë”), 2 nëntor 2001, para. 151.

⁷⁴ Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 355.

⁷⁵ ICTY/TPNJ, *Kunarac et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerë*, para. 148; *Kvočka et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerë*, para. 284.

Elementi mendor (synimi kriminal)

60. Kryesi duhet ta ketë shkaktuar dhembjen dhe vuajtjen në mënyrë të qëllimshme dhe me synime të tilla si marrja e informatave ose e një deklaratë pranuese, ose ndëshkimi, frikësimi, shtrëngimi ose diskriminimi, për çfarëdo arsye, i viktimës ose një personi të tretë.⁷⁶ Është e mjaftueshme që një prej qëllimeve të ndaluara të jetë pjesë e motivit për sjelljen; nuk është e nevojshme që të jetë “qëllimi mbizotërues ose i vetëm” në shkaktimin e dhimbjes apo vuajtjes së rëndë.⁷⁷

(d) Vrasja e paligjshme

Elementët materialë (veprimi i fajshëm)

61. Krimi i vrasjes së paligjshme si krim lufte, brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, kryhet nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që çon në vdekjen e një personi.⁷⁸

Elementi mendor (synimi kriminal)

62. Kryesi duhet ta ketë vrarë personin në mënyrë të qëllimshme ose të ketë shkaktuar qëllimisht dëmtim të rëndë fizik, që kryesi logjikisht duhej ta kishte ditur se mund të çonte në vdekje.⁷⁹

⁷⁶ ICTY/TPNJ, *Kunarac et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerë*, para. 153; *Limaj et al. Trial Judgment /Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë*, para. 235, 239; Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 356.

⁷⁷ ICTY/TPNJ, *Simić et al Trial Judgment/Aktgjykimi Simiq dhe të tjerë*, para. 81; *Kvočka et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Kvočka dhe të tjerë*, para. 153; *Mucić et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Mucić dhe të tjerë*, para. 470; Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 356.

⁷⁸ ICTY/TPNJ, *Kvočka et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerë*, para. 259-261; *Krnojelac Trial Judgment/Aktgjykimi Krnojellac*, para. 326-327.

⁷⁹ ICTY/TPNJ, *Mladić Trial Judgment/Aktgjykimi Mlladiq*, para. 3050; *Kvočka et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerë*, para. 261; ICTR/TPNR, *Setako Appeal*

C. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

63. Prokurori i Specializuar argumenton këto forma të përgjegjesisë penale: kryerje krimi, qoftë kryerja e drejtpërdrejtë dhe kryerja në bazë të një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, si edhe urdhërimi, nxitja, ndihma dhe inkurajimi, dhe përgjegjësia si epror.⁸⁰ Elementët objektivë dhe subjektivë të këtyre formave të përgjegjesisë penale parashtrohen në vijim.

1. Kryerja e drejtpërdrejtë (neni 16(1)(a) i Ligjit)

(a) Elementët objektivë

64. Në kryerjen e drejtpërdrejtë kryesi kryen fizikisht elementët objektivë të krimit ose nuk ndërmerr veprim kur sipas ligjit i kërkohet të veprojë.⁸¹

(b) Elementi subjektiv

65. Kryesi duhet të ketë synimin ta kryejë krimin ose duhet të veprojë i vetëdijshëm për gjasat e konsiderueshme se do të ndodhte krim si pasojë e sjelljes së vet.⁸²

Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Setako*, para. 257; Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatat e Kamboxhias (ECCC), *Duch Trial Judgment/Aktgjykimi Duch*, para. 333.

⁸⁰ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 34.

⁸¹ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tadić*/Prokurori k. Tadiqit, IT-94-1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Tadić*"), 15 korrik 1999, para. 188; *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*/Prokurori k. Bllagojeviqit dhe Jokiqit, IT-02-60-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement/Aktgjykim*, 17 janar 2005, para. 694; *Prosecutor v. Lukić and Lukić*/Prokurori k. Llukiqit dhe Llukiqit, IT-98-32/1-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* ("Aktgjykimi *Llukić*"), 20 korrik 2009, para. 897; ICTR/TPNR, *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*"), 28 nëntor 2007, para. 478; *Prosecutor v. Kayishema and Ruzindana*/Prokurori k. Kayishema dhe Ruzindana, ICTR-95-1-A, Dhoma e Apelit, *Judgment (Reasons)/Aktgjykim (Arsyetimi)* ("Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*"), 1 qershor 2001, para. 187.

⁸² ICTY/TPNJ, *Lukić Trial Judgment/Aktgjykimi Llukić*, para. 900; ICTR/TPNR, *Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kayishema dhe Ruzindana*, para. 187.

2. Ndërmarrje kriminale e përbashkët (neni 16(1)(a) i Ligjit)

66. Ndërmarrja kriminale e përbashkët (“NKP”) si formë e përgjegjesisë penale përfshin tri forma ose kategori (bazë, sistemore dhe e zgjeruar). Në formën bazë (“NKP I”) disa kryes vepronë mbi bazën e një qëllimi të përbashkët; në formën sistemore (“NKP II”) që është një variant i formës së parë, krimet kryhen brenda një sistemi të organizuar keqtrajtimi nga anëtarë të forcave ushtarake ose njësive administrative, si në kampet e përqendrimit ose të ndalimit; në formën e zgjeruar (“NKP III”), vërtetohet përgjegjësia penale për aktet e një bashkëkryesi që dalin jashtë kuadrit të planit të përbashkët, por që ishin pasojë e parashikueshme e realizimit të planit.⁸³

(a) Elementët objektivë

67. Për të gjitha format e NKP-së kërkohet ekzistenca e elementëve objektivë në vijim: (i) një shumësi personash që vepronë në bazë të një qëllimi të përbashkët; (ii) një qëllim i përbashkët i cili përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi sikurse parashikohet në Ligj; dhe (iii) pjesëmarrja e kryesit në realizimin e projektit ose qëllimit të përbashkët.⁸⁴

⁸³ ICTY/TPNJ, *Kvočka et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 82-83; *Prosecutor v. Vasiljević*/Prokurori k. Vasileviqit, IT-98-32-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*”), 25 shkurt 2004, para. 98; *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 196, 202-203, 228. ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Ntakirutimana and Ntakirutimana*/Prokurori k. Ntakirutimana dhe Ntakirutimana, ICTR-96-10-A dhe ICTR-96-17-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*”), 13 dhjetor 2004, para. 464.

⁸⁴ ICTY/TPNJ, *Mladić* Trial Judgment/Aktgjykimi *Mlladiq*, para. 3561; *Prosecutor v. Karadžić*/Prokurori k. Karaxhiqit, IT-95-5/18-T, Dhoma Gjyqësore, *Public Redacted Version of Judgement Issued on 24 March 2016*/Version i redaktuar publik i Aktgjykimit të lëshuar më 24 mars 2016, 24 mars 2016, para. 561, që i referohet *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; *Stakić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 64. *Shih gjithashtu* ICTR/TPNR, *Karempera and Ngirumpatse v. Prosecutor/Karempera dhe Ngirumpatse* k. Prokurorit, ICTR-98-44-A, Dhoma e Apelit, *Judgement*/Aktgjykimi i Apelit, 29 shtator 2014, para. 110; *Ntakirutimana* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 461-468; STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al.* /Prokurori k. Ajashit dhe të tjerëve, STL-11-O1/I, Dhoma e Apelit, *Interlocutory Decision on the Applicable Law: Terrorism, Conspiracy, Homicide, Perpetration, Cumulative Charging* (“Vendim mbi dispozitat ligjore përkatëse *Ajash dhe të tjerë*”), 16 shkurt 2011, para. 236-249.

68. *Shumësi personash.* NKP-ja ekziston kur një shumësi personash merr pjesë në realizimin e një objekti kriminal të përbashkët.⁸⁵ Nuk është e nevojshme që personat pjesëmarrës në ndërmarrjen kriminale të jenë të organizuar në një strukturë ushtarake, politike ose administrative.⁸⁶ Megjithatë, ata duhet të identifikohen konkretisht, për shembull, përmes emrit ose kategorive ose grupeve të personave.⁸⁷

69. *Qëllimi i përbashkët që përbën kryerje të një krimi ose përfshin kryerjen e një krimi.* Nuk është e nevojshme që ky plan, projekt, ose qëllim të jetë organizuar ose formuluar më herët. Plani ose qëllimi i përbashkët mund të materializohet pa përgatitje paraprake dhe deduktohet nga fakti i një shumësie personash që veprojnë së bashku për të realizuar një ndërmarrje kriminale të përbashkët.⁸⁸ Qëllimi i përbashkët nuk presupozon planifikim përgatitor ose marrëveshje të shprehur ndërmjet pjesëmarrësve në NKP, ose ndërmjet pjesëmarrësve në NKP dhe personave të tretë.⁸⁹ Për më tepër, NKP-ja mund të ekzistojë edhe nëse asnjë, ose vetëm disa, prej kryesve fizikë të krimeve janë anëtarë të NKP-së, por përdoren nga një ose më shumë anëtarë të NKP-së për të kryer krimet sipas qëllimit të përbashkët.⁹⁰

⁸⁵ ICTY/TPNJ, *Haradinaj Trial Judgment/Aktgjykimi Haradinaj* para. 138; *Kvočka et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Kvočka dhe të tjerë*, para. 307.

⁸⁶ ICTY/TPNJ, *Mladić Trial Judgment/Aktgjykimi Mladić*, para. 3561; *Tadić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Tadić*, para. 227.

⁸⁷ ICTY/TPNJ, *Mladić Trial Judgment/Aktgjykimi Mladić*, para. 3561; *Prosecutor v. Krajišnik/Prokurori k. Krajišnikut*, IT-00-39-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Krajišnik"), 17 mars 2009, para. 156-157; *Brđanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Brgjanin*, para. 430.

⁸⁸ ICTY/TPNJ, *Tadić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Tadić*, para. 227; *Prosecutor v. Furundžija/Prokurori k. Furunxhijas*, IT-95-17/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 21 korrik 2000, para. 119.

⁸⁹ ICTY/TPNJ, *Haradinaj Trial Judgment/Aktgjykimi Haradinaj*, para. 138; *Brđanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Brgjanin*, para. 418; *Kvočka et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerë*, para. 117-119.

⁹⁰ ICTY/TPNJ, *Mladić Trial Judgment/Aktgjykimi Mladić* para. 3561; *Krajišnik Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Krajišnik*, para. 225-226, 235-236; *Brđanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Brgjanin*, para. 410, 413.

70. Në NKP III kryesi është përgjegjës për krime të kryera jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët, por që megjithatë janë pasojë objektivist e parashikueshme e atij qëllimi të përbashkët.⁹¹

71. *Kontributi*. Kryesi duhet të ketë marrë pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët mbi të cilin bazohet NKP-ja duke ndihmuar ose duke kontribuar për zbatimin e planit ose qëllimit të përbashkët, por nuk është e nevojshme të ketë kryer ndonjë pjesë të veprimit të fajshëm të krimin për të cilin akuzohet.⁹² Ligjërisht nuk është e nevojshme që kontributi i kryesit në NKP të jetë i domosdoshëm ose i konsiderueshëm, por duhet të jetë më së paku një kontribut i qenësishëm në krimet për të cilat ai ose ajo konstatohet se është përgjegjës.⁹³ Nuk është e nevojshme që kontributi në vetvete të jetë kriminal.⁹⁴

(b) Elementi subjektiv

72. Elementët subjektivë ndryshojnë sipas kategorisë së NKP-së nën shqyrtim.

73. Sa i përket NKP I, kryesi duhet të ketë të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë për kryerjen e krimeve që janë pjesë e qëllimit të përbashkët, duke përfshirë edhe synimin konkret.⁹⁵

⁹¹ *Shih* referencën për standardin e “personit me maturi të arsyeshme” në STL/TSL, *Ayyash et al.* Decision on Applicable Law/Vendim mbi dispozitat ligjore përkatëse *Ajash dhe të tjerë*, para. 242.

⁹² ICTY/TPNJ, *Krajišnik* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Krajišnik*, para. 215, 218, 695; *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadić* para. 227.

⁹³ ICTY/TPNJ, *Mladić* Trial Judgment/Aktgjykimi *Mladić*, para. 3561; *Krajišnik* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Krajišnik*, para. 215, 662, 675, 695-696; *Brđanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Brgjanin*, para. 430; *Kvočka et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 97-98.

⁹⁴ ICTY/TPNJ, *Krajišnik* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Krajišnik* para. 695.

⁹⁵ ICTY/TPNJ, *Prokurori k. Gjorgjeviqit*, IT-05-87/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/* Aktgjykimi i Apelit, 27 janar 2014, para. 468.

74. Në lidhje me NKP II, kërkohet njohuria personale për sistemin e keqtrajtimit si edhe synimi për të realizuar këtë sistem të përbashkët dhe të bashkërenduar të keqtrajtimit.⁹⁶

75. Sa i përket NKP III, kryesi është përgjegjës për krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët në qoftë se në rrethanat e rastit (i) kryesi kishte synimin të merrte pjesë dhe të kontribuonte për realizimin e qëllimit të përbashkët; (ii) për kryesin ishte e parashikueshme që krimi i zgjeruar mund të kryhej nga cilido anëtar i grupit, ose nga persona të përdorur nga cilido anëtar i grupit, për realizimin e qëllimit të përbashkët; dhe (iii) kryesi me vullnet të lirë ndërmori rrezikun e mundësisë që të ndodhte krimi i zgjeruar kur mori pjesë në qëllimin e përbashkët.⁹⁷ Parashikueshmëria ndodh kur kryesi ishte i vetëdijshëm se krimi jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët ishte pasojë e mundshme e zbatimit të atij qëllimi të përbashkët.⁹⁸ Kryesi ndërmerr rrezik me vullnet të lirë kur, duke qenë i vetëdijshëm se një krim i tillë është pasojë e mundshme e zbatimit të ndërmarrjes, kryesi vendos të marrë pjesë në atë ndërmarrje.⁹⁹

76. Në përcaktimin nëse krimi ishte i parashikueshëm për kryesin, janë shqyrtuar ndër të tjerë faktorët e mëposhtëm: (i) njohuria për mënyrën e zbatimit të NKP-së në terren;¹⁰⁰ (ii) dijenia për të shkuarën dhe tendencat kriminale të anëtarëve të

⁹⁶ ICTY/TPNJ, *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228; *Limaj et al.* Trial Judgment/Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 511; *Kvočka et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 82.

⁹⁷ ICTY/TPNJ, *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228; *Prokurori k. Shainoviqit dhe të tjerëve*, IT-05-87-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerë*"), 23 janar 2014, para. 1557; *Brđanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Brgjanin*, para. 365, 411; *Stakić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 65; *Kvočka et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 83.

⁹⁸ Mundësia e kryerjes së krimit të zgjeruar duhet të jetë mjaftueshmërisht e konsiderueshme që të jetë logjikisht e parashikueshme mbi bazën e informacionit që dispononte kryesi në atë kohë. *Shih*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*/Prokurori k. Stanishiqit dhe Zhuplaninit, IT-08-91-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit *Stanishiq dhe Zhuplanin*"), 30 qershor 2016, para. 627.

⁹⁹ ICTY/TPNJ, *Brđanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Brgjanin*, para. 411.

¹⁰⁰ ICTY/TPNJ, *Stanišić and Župljanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 627, 1002.

ndërmarrjes për kryerje të krimeve;¹⁰¹ (iii) deklaratat e kryesit;¹⁰² (iv) koha dhe vendi i kryerjes së krimeve jashtë kuadrit të qëllimit të përbashkët;¹⁰³ (v) njohuria për motivet personale të hakmarrjes të anëtarëve të ndërmarrjes ose personave të përdorur prej tyre;¹⁰⁴ (vi) dijenia për urrejtjen etnike ndërmjet palëve në konflikt;¹⁰⁵ dhe (vii) njohuria për veprimtaritë e vartësve kryes në keqtrajtimin e të burgosurve.¹⁰⁶

3. Urdhërimi (neni 16(1)(a) i Ligjit)

(a) Elementët objektivë

77. Urdhërimi kërkon që kryesi në pozitë pushteti *de facto* ose *de jure* të urdhërojë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi një person tjetër që të kryejë një krim.¹⁰⁷ Nuk është e nevojshme që ky pushtet të jetë zyrtar, madje ai mund të jetë edhe i përkohshëm.¹⁰⁸ Kryesi mbahet përgjegjës në qoftë se krimi kryhet ose tentohet të kryhet. Urdhri duhet të ketë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm

¹⁰¹ ICTY/TPNJ, *Stanišić and Župljanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 628, 647, 1002.

¹⁰² ICTY/TPNJ, *Šainović et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Shainović dhe të tjerë*, para. 1090.

¹⁰³ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Popović et al. /Prokurori k. Popoviqit dhe të tjerëve*, IT-05-88-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Popoviq dhe të tjerë"), 30 janar 2015, para. 1434.

¹⁰⁴ ICTY/TPNJ, *Popović et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Popoviq dhe të tjerë*, para. 1434.

¹⁰⁵ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tolimir/Prokurori k. Tolimirit*, IT-05-88/2-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Tolimir"), 8 prill 2015, para. 520; *Stanišić and Župljanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 1002.

¹⁰⁶ ICTY/TPNJ, *Tolimir Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Tolimir*, para. 539.

¹⁰⁷ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Blaškić/Prokurori k. Bllashkiqit*, IT-95-14-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* ("Aktgjykimi Bllashkiq"), 3 mars 2000, para. 282; *Prosecutor v. Tolimir/Prokurori k. Tolimirit*, IT-05-88/2-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* ("Aktgjykimi Tolimir"), 12 dhjetor 2012, para. 905.

¹⁰⁸ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Dragomir Milošević/Prokurori k. Dragomir Millosheviqit*, IT-98-29/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 12 nëntor 2009, para. 290; *Kordić and Čerkez Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Čerkez*, para. 28; ICTR/TPNR, *Semanza v. Prosecutor/Semanza k. Prokurorit*, ICTR-97-20-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Semanza"), 20 maj 2005, para. 363.

mbi kryerjen e krimit ose mbi tentimin e kryerjes së krimit.¹⁰⁹ Megjithatë, është e panevojshme të vërtetohet që krimi nuk do të ishte kryer në mungesë të urdhrit.¹¹⁰

(b) Elementi subjektiv

78. Kryesi duhet të ketë synimin e urdhërimit të krimit, ose të paktën duhet të jetë i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme se me zbatimin e veprimit të urdhëruar do të kryhej krim.¹¹¹

4. Nxitja (neni 16(1)(a) i Ligjit)

(a) Elementët objektivë

79. Nxitja kërkon që kryesi, përmes sjelljes së nënkuptuar ose të shprehur,¹¹² të nxisë një person tjetër të kryejë një vepër penale,¹¹³ e cila faktikisht kryhet.¹¹⁴ Nuk është e nevojshme të vërtetohet se krimi nuk do të ishte kryer pa përfshirjen e kryesit; mjafton të tregohet se nxitja ishte një faktor që kontribuoi konsiderueshëm në sjelljen e një personi tjetër që kryen krimin.¹¹⁵ Gjithashtu, nuk është e nevojshme të provohet se kryesi kishte kontroll efektiv apo ndonjë pozitë tjetër pushteti mbi kryesin fizik.¹¹⁶

¹⁰⁹ ICTY/TPNJ, *Tolimir Trial Judgment/Aktgjykimi Tolimir*, para. 905; ICTR/TPNR, *Kamuhanda v. Prosecutor/Kamuhanda k. Prokurorit*, ICTR-99-54A-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/ Aktgjykimi i Apelit*, 19 shtator 2005, para. 75.

¹¹⁰ ICTY/TPNJ, *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 332.

¹¹¹ ICTR/TPNR, *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 481; ICTY/TPNJ, *Kordić and Čerkez Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kordić dhe Čerkez*, para. 29-30; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkić*, para. 42.

¹¹² ICTY/TPNJ, *Tolimir Trial Judgment/Aktgjykimi Tolimir*, para. 902; *Orić Trial Judgment/Aktgjykimi Orić*, para. 273; *Prosecutor v. Brđanin/Prokurori k. Brgjaninit*, IT-99-36-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement ("Aktgjykimi Brgjanin")*, 1 shtator 2004, para. 269; ICTR/TPNR, *Prosecutor v. Akayesu/Prokurori k. Akayesu*, ICTR-96-4-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 1 qershor 2001, para. 478.

¹¹³ ICTY/TPNJ, *Kordić and Čerkez Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kordić dhe Čerkez*, para. 27.

¹¹⁴ ICTY/TPNJ, *Orić Trial Judgment/Aktgjykimi Orić*, para. 269; *Brđanin Trial Judgment/Aktgjykimi Brgjanin*, para. 267.

¹¹⁵ ICTY/TPNJ, *Kordić and Čerkez Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kordić dhe Čerkez*, para. 27.

¹¹⁶ ICTY/TPNJ, *Tolimir Trial Judgment/Aktgjykimi Tolimir*, para. 902; *Orić Trial Judgment/Aktgjykimi Orić*, para. 272; ICTR/TPNR, *Semanza Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Semanza*, para. 257.

(b) Elementi subjektiv

80. Kryesi duhet të ketë synimin të nxisë një person tjetër që të kryejë një krim, ose më së paku duhet të jetë i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme se përmes zbatimit të sjelljes së nxitur do të kryhet krim.¹¹⁷ Kryesi duhet të ketë të njëjtin synim konkret.¹¹⁸

5. Ndhurma dhe inkurajimi (neni 16(1)(a) i Ligjit)

(a) Elementët objektivë

81. Ndhurma dhe inkurajimi, qoftë përmes veprimit ose mosveprimit,¹¹⁹ kërkon që kryesi të ndihmojë, inkurajojë, ose të japë mbështetje morale për kryerjen e një krimi, kur kjo mbështetje ka ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimit.¹²⁰ Ndhurma dhe inkurajimi mund të ndodhë para, gjatë, ose pas kryerjes së krimit dhe në një vend të ndryshëm nga ai i krimit.¹²¹ Është e panevojshme të vërtetohet se

¹¹⁷ IRMCT, *Ngirabatware v. Prosecutor*/Ngirabatware k. Prokurorit, MICT-12-29-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 18 dhjetor 2014, para. 166; ICTY/TPNJ, *Kordić and Čerkez Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Çerkez*, para. 29, 32; ICTR/TPNR, *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 480.

¹¹⁸ ICTR/TPNR, *Nchamihigo v. Prosecutor*/Nchamihigo k. Prokurorit, ICTR-01-63-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 18 mars 2010, para. 61; *Prosecutor v. Seromba*/Prokurori k. Seromba, ICTR-2001-66-A, Dhoma e Apelit, *Judgement*,/ Aktgjykimi i Apelit 12 mars 2008, para. 175.

¹¹⁹ ICTY/TPNJ, *Mrkšić and Šljivančanin*, IT-95-13/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Mrkshiq dhe Shlivančanin"), 5 maj 2009, para. 49, 134, 154; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 47.

¹²⁰ ICTY/TPNJ, *Tadić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Tadiq*, para. 229; *Vasiljević Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Vasileviq* para. 102; *Prosecutor v. Aleksovski*/Prokurori k. Aleksovskit, IT-95-14/1-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Aleksovski"), 24 mars 2000, para. 162, 164; ICTR/TPNR, *Kalimanzira v. Prosecutor*/Kalimanzira k. Prokurorit, ICTR-05-88-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Kalimanzira"), 20 tetor 2010, para. 74; *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 482; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*/Prokurori k. Tejlërit, SCSL-03-01-A, Dhoma e Apelit, *Judgment* ("Aktgjykimi i Apelit Tejlër"), 26 shtator 2013, para. 475.

¹²¹ ICTY/TPNJ, *Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Mrkshiq dhe Shlivančanin*, para. 81; *Prosecutor v. Simić*/Prokurori k. Simiqit, IT-95-9-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* ("Aktgjykimi i Apelit Simiq"), 28 nëntor 2006, para. 85; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 48; *Mucić et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Muciq dhe të tjerë*, para. 352; ICTR/TPNR, *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 482.

krimi nuk do të ishte kryer pa kontributin e ndihmuesit e inkurajuesit¹²² apo se ekzistonte një plan apo marrëveshje ndërmjet ndihmuesit e inkurajuesit dhe kryesit.¹²³ Po kështu, nuk është kusht të provohet se veprimet e ndihmuesit e inkurajuesit kishin objektivin konkret për të ndihmuar, inkurajuar, ose për të dhënë mbështetje morale për kryerjen e krimeve.¹²⁴

(b) Elementi subjektiv

82. Ndihmuesi e inkurajuesi duhet të ketë njohuri se veprimet ose mosveprimet e veta ndihmojnë në kryerjen e krimit nga kryesi.¹²⁵ Në veçanti, ndihmuesi e inkurajuesi duhet të ketë dijeni për elementët thelbësorë të krimit që u krye,¹²⁶ ndër të cilët për gjendjen mendore të kryesit dhe çfarëdo synimi konkret që ka lidhje me të,¹²⁷ por nuk është e nevojshme që ai ose ajo të ketë atë synim konkret.¹²⁸

¹²² ICTY/TPNJ, *Mrkšić and Šljivančanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mrkshiq dhe Shlivančanin*, para. 81; *Simić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 85; *Blašić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48.

¹²³ ICTY/TPNJ, *Brđanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Brgjanin*, para. 263; *Tadić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229.

¹²⁴ ICTY/TPNJ, *Šainović et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Shainoviq dhe të tjerë*, para. 1649-1651.

¹²⁵ ICTY/TPNJ, *Vasiljević* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102; ICTR/TPNR, *Kalimanzira* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kalimanzira*, para. 86; SCSL, *Taylor* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Tejlër*, para. 437.

¹²⁶ ICTY/TPNJ, *Mrkšić and Šljivančanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mrkshiq dhe Shlivančanin*, para. 49, 159; *Brđanin* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Brgjanin*, para. 484.

¹²⁷ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*/Prokurori k. Bllagojeviqit dhe Jokiqit, IT-02-60-A, Dhoma e Apelit, *Judgement*/Aktgjykimi i Apelit, 9 maj 2007, para.127; *Vasiljević* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 142; *Prosecutor v. Krnojelac*/Prokurori k. Krnojellacit, IT-97-25-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Krnojellac*”), 17 shtator 2003, para. 52.

¹²⁸ ICTY/TPNJ, *Simić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, para. 86; *Krnojelac* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Krnojellac*, para. 52; *Aleksovski* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 162.

6. Përgjegjësia eprorë (neni 16(1)(c) i Ligjit)

(a) Elementët objektivë

83. Që eprori të mbajë përgjegjësi penale, duhet të vërtetohen elementët objektivë në vijim: (i) ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës dhe (ii) mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme nga eprori për parandalimin e krimit ose të krimeve të vartësit ose vartësve të tij, ose mosndëshkimi prej tij i kryesve për ato krime.¹²⁹ Neni 16 i Ligjit nuk parasheh kushtin e ekzistencës së shkakësisë ndërmjet mosparandalimit të krimit prej eprorit dhe ndodhjes së krimit.¹³⁰

84. *Ekzistenca e marrëdhënies epror-vartës*. Kryesi duhet të jetë epror me pushtet *de jure* ose *de facto*¹³¹ mbi vartësit të cilët kanë kryer një ose më shumë krime sipas neneve 13-14 të Ligjit. Kjo marrëdhënie mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë,¹³² brenda një hierarkie që është zyrtare ose jozyrtare,¹³³ dhe civile ose ushtarake.¹³⁴ Për të mbajtur përgjegjësi, eprori duhet të ketë aftësinë materiale të parandalojë ose ndëshkojë vartësin në kohën e kryerjes së krimit (“kontroll efektiv”).¹³⁵ Ndër faktorët që duhen marrë parasysh në vlerësimin e kontrollit

¹²⁹ ICTY/TPNJ, *Aleksovski* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 72; ICTR/TPNR, *Nahimana et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*, para. 484.

¹³⁰ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Hadžihasanović and Kubura*/Prokurori k. Haxhihasanović dhe Kuburës, IT-01-47-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanović dhe Kubura*”), 22 prill 2008, para. 38-40; *Blaškić* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 73-77.

¹³¹ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mucić dhe të tjerë*, para. 192-193, 195; ICTR/TPNR, *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 294.

¹³² ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Halilović*/Prokurori k. Halilović, IT-01-48-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* (“Aktgjykimi i Apelit *Halilović*”), 16 tetor 2007, para. 59; *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mucić dhe të tjerë*, para. 252, 303.

¹³³ ICTY/TPNJ, *Halilović* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Halilović*, para. 59; *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mucić dhe të tjerë*, para. 197, 303; ICTR/TPNR, *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, para. 294.

¹³⁴ ICTY/TPNJ, *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mucić dhe të tjerë*, para. 195-196; ICTR/TPNR, *Kajelijeli v. Prosecutor/Kajelijeli* k. Prokurorit, ICTR-98-44A-A, Dhoma e Apelit, *Judgement* /Aktgjykimi i Apelit, 23 maj 2005, para. 85.

¹³⁵ ICTY/TPNJ, *Aleksovski* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para. 76; *Halilović* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Halilović*, para. 59; *Mucić et al.* Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit *Mucić dhe të tjerë*, para. 191-192, 196-198, 256, 266, 303; ICTR/TPNR, *Prosecutor v.*

efektiv përfshihen, ndër të tjera: (i) pozita e kryesit; (ii) aftësia e kryesit për të lëshuar urdhra dhe nëse këta urdhra u zbatuan faktikisht; (iii) autoriteti për të marrë masa disiplinore; dhe (iv) kompetenca për të ngritur në përgjegjësi ose për të shkarkuar nga detyra anëtarët e personelit.¹³⁶

85. *Mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme.* Eprori ka dy detyra të dallueshme: detyrën për të parandaluar krime (të ardhshme) dhe detyrën për të ndëshkuar vartësin për krime (të shkuara).¹³⁷ Detyra e eprorit për parandalim buron që prej momentit kur eprori di ose ka arsye të dijë se një vartës nën kontrollin efektiv të tij është në prag të kryerjes së një krimi, ndërsa detyra e ndëshkimit buron pasi vartësi e ka kryer krimin.¹³⁸ Eprori mund të mbahet përgjegjës për shkeljen e çdonjërës prej këtyre dy detyrave. Rrjedhimisht, mosparandalimi i krimit nuk mund të ndreqet më pas duke e ndëshkuar vartësin për krimin.¹³⁹

86. Masa “të nevojshme” janë masat e përshtatshme që eprori të përmbushë detyrën e vet për të bërë përpjekje të mirëfillta për parandalim ose ndëshkim,

Ntawukulilyayo/Prokurori k. Ntawukulilyayo, ICTR-05-82-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement and Sentence/Aktgjykim dhe dënim* (“Aktgjykimi *Ntawukulilyayo*”), 3 gusht 2010, para. 420; *Prosecutor v. Karera/Prokurori k. Kareras*, ICTR-01-74-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement and Sentence/Aktgjykim dhe dënim*, 7 dhjetor 2007, para. 564; *Kayishema and Ruzindana Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Kayishema dhe Ruzindana*, para. 294.

¹³⁶ ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Perišić/Prokurori k. Perišiqit*, IT-04-81-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 28 shkurt 2013, para. 97; *Strugar Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Strugar*, para. 254; *Halilović Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Halilović*, para. 66; *Orić Trial Judgment/Aktgjykimi i Apelit Orić*, para. 312; *Mucić et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Muciq dhe të tjerë*, para. 190, 206.

¹³⁷ ICTY/TPNJ, *Prokurori k. Gjorgjeviqit*, IT-05-87/1-T, Dhoma Gjyqësore, *Public Judgment with Confidential Annex/Aktgjykim publik me shtojcë konfidenciale* (“Aktgjykimi *Gjorgjeviq*”), 23 shkurt 2011, para. 1888; *Prosecutor v. Delić/Prokurori k. Deliqit* IT-04-83-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement* (“Aktgjykimi *Deliq*”), 15 shtator 2008, para. 69; *Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Haxhihasanović dhe Kubura*, para. 259; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 83; *Mucić et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Muciq dhe të tjerë*, para. 333-334.

¹³⁸ ICTY/TPNJ, *Delić Trial Judgment/Aktgjykimi Deliq*, para. 69, 72; *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 416; *Prosecutor v. Kordić and Čerkez/Prokurori k. Kordiqit dhe Çerkezit*, IT-95-14/2-T, Dhoma Gjyqësore, *Judgement/Aktgjykim*, 26 shkurt 2001, para. 445-446.

¹³⁹ ICTY/TPNJ, *Delić Trial Judgment/Aktgjykimi Deliq*, para. 69; *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 373; *Blaškić Trial Judgment/Aktgjykimi Bllashkiq*, para. 336.

ndërsa masa “të arsyeshme” janë ato që përfshihen logjikisht në kompetencat materiale të eprorit.¹⁴⁰ Se çfarë është “e nevojshme dhe e arsyeshme” varet nga provat dhe duhet të vlerësohet konkretisht.¹⁴¹ Në detyrën e parandalimit mund të përfshihen masa si: (i) sigurimi i raporteve që veprimet ushtarake janë kryer në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;¹⁴² (ii) lëshimi i urdhrave që synojnë përputhshmërinë e praktikave përkatëse me rregullat e konfliktit të armatosur;¹⁴³ (iii) marrja e masave disiplinore për të parandaluar kryerjen e mizorive; ose (iv) insistimi para një autoriteti epror për marrjen e masave të menjëhershme.¹⁴⁴ Në detyrën e ndëshkimit mund të përfshihen, më së paku (i) detyrimi për të hetuar krime të mundshme ose për të kërkuar që çështja të hetohet, dhe, (ii) në qoftë se eprori nuk ka kompetenca për të ndëshkuar, të bëjë raportim tek autoritetet kompetente.¹⁴⁵ Shkalla e kontrollit efektiv mund të përdoret për të përcaktuar se cilat masa janë të nevojshme dhe të arsyeshme brenda kompetencës së eprorit.¹⁴⁶

¹⁴⁰ ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1887; *Prosecutor v. Orić/Prokurori k. Oriqit*, IT-03-68-A, Dhoma e Apelit, *Judgement/Aktgjykimi i Apelit*, 3 korrik 2008, para. 177; *Halilović Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Halilović*, para. 63.

¹⁴¹ ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1887; *Delić Trial Judgment/Aktgjykimi Deliq*, para. 76; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 72, 417.

¹⁴² ICTY/TPNJ, *Delić Trial Judgment/Aktgjykimi Deliq*, para. 76; *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 374.

¹⁴³ ICTY/TPNJ, *Delić Trial Judgment/Aktgjykimi Deliq*, para. 76; *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 374.

¹⁴⁴ ICTY/TPNJ, *Strugar Trial Judgment/Aktgjykimi Strugar*, para. 374.

¹⁴⁵ ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1890; *Hadžihasanović and Kubura Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Haxhihasanović dhe Kubura*, para. 154; *Halilović Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Halilović*, para. 182; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 83.

¹⁴⁶ ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment /Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1887; *Halilović Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Halilović*, para. 63; *Blaškić Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Bllashkiq*, para. 72.

(b) Elementi subjektiv

87. Sipas nenit16(1)(c) të Ligjit, eprorët duhet të kenë ditur faktikisht¹⁴⁷ ose duhet të kenë pasur arsye të dinin se vartësit ishin në prag të kryerjes së një krimi apo e kishin kryer atë. Për të përcaktuar nëse eprorët “kishin arsye të dinin”, duhet të vërtetohet se ata duhet të kenë disponuar informacion mjaftueshmërisht alarmues që i vinte në dijeni të krimeve të kryera ose në prag të kryerjes prej vartësve të tyre dhe i cili përlligjte hetim të mëtejshëm.¹⁴⁸ Nuk është e nevojshme që eprori të ketë të njëjtin synim, në veçanti të njëjtin synim konkret, si vartësi.¹⁴⁹ Njohuria kërkon vlerësim të situatës konkrete të eprorit gjatë kohës në fjalë.¹⁵⁰

VI. AKUZAT

88. Përpara shqyrtimit të materialit mbështetës në lidhje me secilën akuzë dhe nxjerrjes së konstatimit nëse është vërtetuar një dyshim i bazuar mirë kundër z. Mustafa, gjykatësi i procedurës paraprake vëren se ZPS-ja i ka përmbushur kriteret e rregullës 86(3) të Rregullores përmes dorëzimit të (i) një aktakuze të

¹⁴⁷ Ndër faktorët për nxjerrjen e konstatimit për dijeni faktike të eprorit përfshihen, për shembull: numri i akteve të paligjshme, çka përfshihet në to, sa të përhapur janë, koha e ndodhjes së tyre, lloji dhe numri i vartësve të përfshirë, mjetet e disponueshme të komunikimit, fushëveprimi dhe lloji i pozitës së eprorit dhe vendndodhja e tij në atë kohë, dhe vendndodhja gjeografike e krimeve, *shih* ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1885; *Orić Trial Judgment/Aktgjykimi Oriq*, para. 319; *Blaškić Trial Judgment/Aktgjykimi Bllashkiq*, para. 307; *Mucić et al. Trial Judgment/Aktgjykimi Muciq dhe të tjerë*, para. 386; ICTR/TPNR, *Ntawukulilyayo Trial Judgment/Aktgjykimi Ntawukulilyayo dhe të tjerë*, para. 420-421.

¹⁴⁸ ICTY/TPNJ, *Dorđević Trial Judgment/Aktgjykimi Gjorgjeviq*, para. 1886; *Krnojelac Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Krnojellac*, para. 59, 155; *Mucić et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Muciq dhe të tjerë*, para. 238-239, 241; ICTR/TPNR, *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 791; *Prosecutor v. Bagilishema/Prokurori k. Bagilishema*, ICTR-95-1-A, *Dhoma e Apelit, Judgement (Reasons)/Aktgjykimi i Dhomës së Apelit (Arsyetim)* 3 korrik 2002, para. 28, 42.

¹⁴⁹ ICTY/TPNJ, *Brđanin Trial Judgment/Aktgjykimi Brgjanin*, para. 720-721; *Krnojelac Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Krnojellac*, para. 155; ICTR/TPNR, *Nahimana et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Nahimana dhe të tjerë*, para. 865.

¹⁵⁰ ICTY/TPNJ, *Krnojelac Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Krnojellac*, para. 156; *Mucić et al. Appeal Judgment/Aktgjykimi i Apelit Muciq dhe të tjerë*, para. 239.

rishikuar për herë të dytë; (ii) materialit provues që mbështet faktet mbi të cilat janë ngritur akuzat; dhe (iii) një përmbledhjeje që tregon lidhjen e secilës provë të materialit provues me secilën akuzë.

A. ELEMENTËT KONTEKSTUALË TË KRIMEVE TË PARAQITURA NË AKTAKUZË

89. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se krimet e paraqitura në aktakuzë ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur dhe në lidhje me këtë konflikt në Kosovë, ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) dhe forcave të RFJ-së dhe të Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si edhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe të Serbisë (të quajtura së bashku “forcat serbe”).¹⁵¹

90. Në lidhje me ekzistencën e luftimeve, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon që para, gjatë dhe pas periudhës që ka lidhje me akuzat në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, në territorin e Kosovës pati dhunë të armatosur ndërmjet forcave serbe nga njëra anë dhe UÇK-së nga ana tjetër.¹⁵²

91. Në lidhje me palët pjesëmarrëse në luftime, materiali mbështetës tregon se forcat serbe vepronin si organe të pushtetit të qeverive të RFJ-së dhe të Republikës së Serbisë.¹⁵³ Gjithashtu, materiali mbështetës tregon se UÇK-ja ishte një entitet i organizuar me strukturë komanduese, që dispononte kapacitet të konsiderueshëm operativ, duke përfshirë edhe armatime, si dhe ushtronte kontroll territorial. Më

¹⁵¹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 3

¹⁵² 074222-074225, f. 1 (074222); 074226-074231, f. 1-2 (074226-074227); K0223066-K0223071 (IT-05-87-P00444), f. 1-3 (0223066-0223068); U0038552-U0038690, f. 107 (U0038658), f. 109 (U0038660), f. 115 (U0038666) dhe f. 131 (U0038682); IT-05-87.1, ndër të tjera në f. 23 (03524828), f. 24-25 (03524830-03524831), f. 30 (03524848), f. 31 (03524852), f. 40 (03525165), f. 52 (03525239), f. 162 (03525493) dhe në vijim.

¹⁵³ U003-8552-U003-8690, f. 60 (U0038611), f. 62 (U0038613), f. 68 (U0038619); IT-05-87 P01975-E; IT-05-87.1 P01029, f. 105 (03525372), f. 144 (03525440), f. 157 (03525485), f. 161 (03525491), f. 167 (03525506).

konkretisht, ajo lëshoi urdhra të ndryshëm për rekrutimin dhe mobilizimin e forcave për t'iu kundërvënë ofensivës serbe, në veçanti që prej fundit të marsit 1999.¹⁵⁴ Gjithashtu ajo lëshoi rregullisht komunikata dhe deklarata politike me anë të të cilave bënte përditësime lidhur me operacionet e saj ushtarake.¹⁵⁵ Më tej, UÇK-ja kishte një strukturë komanduese të centralizuar që përbëhej nga një Shtab i Përgjithshëm dhe një strukturë në terren të përbërë nga komandantët e zonave operative.¹⁵⁶ Po kështu, UÇK-ja që në gjendje të fliste përmes zëdhënësve¹⁵⁷ dhe të merrte pjesë në bisedimet për paqe.¹⁵⁸ UÇK-ja ushtroi kontroll solid territorial në pjesë të mëdha të Kosovës, të cilin e zbatonte përmes strukturës së saj komanduese të centralizuar deri tek struktura në terren e komandantëve të zonave operative,¹⁵⁹ që rezultoi në aftësinë e UÇK-së për të kryer operacione ushtarake të bashkërenduara.¹⁶⁰ Ajo gjithashtu dispononte armatime të rënda për këtë qëllim.¹⁶¹ Njësitë gueril BIA ("Njësitë BIA") ishte pjesë e strukturës organizative të UÇK-së dhe vepronte në pjesë të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë edhe në Zllash.¹⁶² Ai gjithashtu u ndihmonte disa zonave të ndryshme

¹⁵⁴ SPOE00054519-SPOE00054522-ET, f. 1-2 (SPOE00054519-SPOE00054520-ET), f. 2-3 (SPOE00054520-SPOE00054521-ET), f. 3-4 (SPOE00054521-SPOE00054522-ET).

¹⁵⁵ U003-8552-U003-8690, për shembull f. 107 (U0038658), f. 109 (U0038660), f. 112 (U0038663), f. 113 (U0038664), f. 115 (U0038666), f. 116 (U0038667), f. 122 (U0038673), f. 130 (U0038681), f. 132 (U0038683), f. 137 (U0038688), dhe f. 138 (U0038688).

¹⁵⁶ U003-8552-U003-8690, f. 91 (U0038642), f. 109 (U0038660), f. 115 (U0038666); SPOE00054519-SPOE00054522-ET, f. 2 (SPOE00054520); SPOE00054519-SPOE00054522-ET, f. 4 (SPOE00054522); IT-05-87.1 P01029, f. 4 (03524677).

¹⁵⁷ U003-8552-U003-8690, f. 24 (U0038575), f. 29 (U0038580), f. 35 (U0038586), f. 43 (U0038594), f. 90 (U0038641), f. 133 (U0038684).

¹⁵⁸ U003-8552-U003-8690, për shembull f. 110 (U0038661), f. 112 (U0038663), f. 130 (U0038681), f. 132 (U0038683).

¹⁵⁹ U003-8552-U003-8690, f. 109 (U0038660), f. 115 (U0038666). *Shih gjithashtu* SPOE00054519-SPOE00054522-ET, f. 2 (SPOE00054520), f. 4 (SPOE00054522); IT-05-87.1 P01029, f. 4 (03524677).

¹⁶⁰ U0038552-U0038690, f. 107 (U0038658), f. 113 (U0038664), f. 115 (U0038666). *Shih gjithashtu* [E REDAKTUAR], Pjesa 2, f. 4, 8; Pjesa 3, f. 12, ku shpjegohet se njësitë gueril BIA, si pjesë e UÇK-së, ishte i pranishëm në disa zona të ndryshme.

¹⁶¹ IT-05-87 P01975-E, f. 1, me të cilën Komanda e Përbashkët Serbe për Kosovën dhe Metohinë informon trupat në terren para një operacioni kundër UÇK-së për armët që dispononte UÇK-ja.

¹⁶² [E REDAKTUAR], Pjesa 2, f. 4; Pjesa 3, f. 12.

operative me logjistikë.¹⁶³ Detyrat e njësitit BIA përfshinin furnizimin me armë, furnizimet mjekësore, propagandën dhe mbledhjen e informatave të zbulimit.¹⁶⁴

92. Në lidhje me nivelin e intensitetit, materiali mbështetës tregon se, gjatë gjithë kohës që ka lidhje me akuzat si dhe në periudhën kohore pararendëse, u zhvilluan luftime të ashpra ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së në pjesë të ndryshme të Kosovës,¹⁶⁵ edhe në sajë të disponueshmërisë së armatimeve të rënda nga të dyja palët,¹⁶⁶ ndër të cilat edhe tanke¹⁶⁷ dhe mortaja.¹⁶⁸ Kishte raportime edhe për sulme snajperësh¹⁶⁹ dhe djegie shtëpish¹⁷⁰. Në veçanti, raportet e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët përmendin veprime luftarake në vijimësi që shkaktuan eksod të konsiderueshëm të personave të zhvendosur drejt vendeve fqinje.¹⁷¹

93. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e sipërpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë që, më së paku gjatë periudhës që lidhet me akuzat në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ekzistonte konflikt i armatosur jondërkombëtar ndërmjet forcave serbe dhe UÇK-së brenda kuptimit të nenit 14(2) të Ligjit.

¹⁶³ [E REDAKTUAR], Pjesa 2, f. 8.

¹⁶⁴ [E REDAKTUAR], Pjesa 2, f. 8.

¹⁶⁵ U003-8552-U003-8690, f. 107 (U0038658), f. 109 (U0038660), f. 115 (U0038666), f. 131 (U0038682); IT-05-87 P00444, f. 1-3 (K0223066-K0223068); 074222-074225, f. 1 (074222); IT-05-87.1 P01029, ndër të tjera në f. 23 (03524828), f. 24-25 (03524830-03524831), f. 30 (03524848), f. 31 (03524852), f. 40 (03525165), f. 52 (03525239), f. 162 (03525493).

¹⁶⁶ IT-05-87.1 P01029, f. 36 (03524860); IT-05-87 P01975-E, f. 1.

¹⁶⁷ U003-8552-U003-8690, f. 60 (U0038611), f. 102 (U0038653), f. 122 (U0038673); IT-05-87.1 P01029, f. 17 (03524808), f. 21 (03524820), f. 31 (03524852), f. 41 (03525176), f. 64 (03525270), f. 74 (03525295), f. 84 (03525312), f. 95 (03525354), f. 134 (03525427), f. 141 (03525437), f. 156 (03525482).

¹⁶⁸ IT-05-87.1 P01029, f. 31 (03524852), f. 40 (03525165), f. 52 (03525239), f. 61 (03525264), f. 62 (03525266), f. 64 (03525270), f. 123 (03525396), f. 126 (03525414), f. 182 (03525541).

¹⁶⁹ IT-05-87.1 P01029, f. 61 (03525264), f. 143 (03525439).

¹⁷⁰ U003-8552-U003-8690, f. 73 (U0038624), f. 122 (U0038673), f. 126 (U0038677); IT-05-87.1 P01029, f. 51 (03525238), f. 55 (03525246), f. 62 (03525265), f. 67 (03525280), f. 74 (03525295), f. 81 (03525321), f. 135 (03525428), f. 137 (03525432), f. 142 (03525439), f. 144 (03525440), f. 149 (03525461), f. 164 (03525497).

¹⁷¹ 074222-074225, f. 1 (074222); 074226-074231, f. 1-5 (074226-074230).

B. KRIMET E PARAQITURA NË AKTAKUZË

1. Pika 1: Heqja arbitrare e lirisë si krim lufte

94. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, të paktën gjashtë personave iu hoq liria në mënyrë arbitrare në kompleksin e ndalimit në Zllash, që përbën krimin e luftës të ndalimit arbitrar sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.¹⁷²

95. Për sa u përket elementëve materialë të krimit, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që materiali mbështetës tregon se më 1 prill 1999, ose rreth asaj date, të paktën gjashtë persona nga zona të ndryshme të Kosovës u arrestuan nga anëtarë të UÇK-së dhe në vijim u mbajtën të ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash.¹⁷³ Të ndaluarit në fjalë u mbajtën në një dhomë të kyçur me zinxhirë dhe të ruajtur me roja.¹⁷⁴ Gjashtë persona u mbajtën të ndaluar për 18 ditë, deri më 19 prill 1999 ose rreth asaj date.¹⁷⁵ Një person i shtatë u mbajt i ndaluar për tri ditë.¹⁷⁶

96. Sipas materialit mbështetës, arrestimi dhe ndalimi i këtyre individëve nuk u përligj as në bazë të një procesi penal dhe as prej arsyeve për të besuar se heqja e lirisë ishte absolutisht e domosdoshme për shkak të sigurisë. Në veçanti, të ndaluarit në fjalë u mbajtën atje për shkak të miqësisë apo kontakteve të pretenduara të tyre me serbë, për shkak të pasurisë së pretenduar të tyre, ose për

¹⁷² Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 18, 35.

¹⁷³ [E REDAKTUAR].

¹⁷⁴ [E REDAKTUAR].

¹⁷⁵ [E REDAKTUAR].

¹⁷⁶ [E REDAKTUAR].

simpatitë e tyre politike.¹⁷⁷ [E REDAKTUAR]¹⁷⁸. [E REDAKTUAR]¹⁷⁹, [E REDAKTUAR]¹⁸⁰.

97. Të ndaluarit nuk u informuan për arsyet e arrestimit dhe të ndalimit të tyre dhe as nuk iu tregua ndonjë dokument në lidhje me këtë. Gjatë gjithë kësaj kohe, këtyre të ndaluarve nuk iu dha mundësia të paraqisnin ankesë lidhur me ligjshmërinë e ndalimit të tyre. Në kohën e lirimit të tyre më 19 prill 1999 – dita e ofensivës serbe në atë zonë¹⁸¹ – [E REDAKTUAR]¹⁸² [E REDAKTUAR].¹⁸³

98. Për sa i përket statusit të mbrojtur të viktimave, materiali mbështetës tregon se në kohën që lidhet me akuzat të ndaluarit në fjalë nuk merrnin pjesë aktive në luftime për shkak se ishin të ndaluar.

99. Për sa i përket elementit mendor të krimit, synimi i z. Mustafa dhe i anëtarëve të tjerë të UÇK-së rrjedh nga mënyra e qëllimshme e mbajtjes arbitrare të të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash, pa u dhënë atyre asnjë garanci bazë. Një tregues i mëtejshëm i synimit të z. Mustafa për të kryer krimin, sikurse sugjerohet në materialin mbështetës, është se ai në asnjë kohë nuk kishte synimin t'i lironte të ndaluarit apo t'u jepte atyre ndonjë garanci bazë, përveçse kur forcat serbe iu afruan kompleksit të ndalimit në Zllash, moment në të cilin të ndaluarit papritur u liruan dhe forcat e UÇK-së u përgatitën për tërheqje.¹⁸⁴

100. Për lidhjen me konfliktin, materiali mbështetës tregon se arrestimet, transferimet dhe ndalimet e sipërpërmendura ndodhën në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar që po zhvillohej midis forcave serbe dhe UÇK-së.

¹⁷⁷ [E REDAKTUAR].

¹⁷⁸ [E REDAKTUAR].

¹⁷⁹ [E REDAKTUAR].

¹⁸⁰ [E REDAKTUAR].

¹⁸¹ [E REDAKTUAR].

¹⁸² [E REDAKTUAR].

¹⁸³ [E REDAKTUAR].

¹⁸⁴ [E REDAKTUAR].

Gjatë periudhës që lidhet me Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ushtarët e BIA-s që ishin të vendosur në Zllash¹⁸⁵ raportonin informata zbulimi në lidhje me shqiptarët për të cilët besohej se ndihmonin forcat serbe.¹⁸⁶ Në veçanti, të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u morën në pyetje dhe u akuzuan, ndër të tjera, se shoqëroheshin me serbë, se bashkëpunonin me ta, ose se ishin spiunë.¹⁸⁷

101. Së fundi, për sa i përket dijenisë për rrethanat faktike që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave, materiali mbështetës sugjeron se gjatë gjithë kohës midis afërsisht 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, anëtarët e UÇK-së dhe z. Mustafa kishin dijeni për ekzistencën e një konflikti të armatosur jondërkombëtar, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga njësitë BIA në përgjithësi dhe pozitën e z. Mustafa si komandant i BIA-s në veçanti.¹⁸⁸ Nëse merret parasysh pozita komanduese e z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash¹⁸⁹ dhe pjesëmarrja e tij në kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së,¹⁹⁰ ata gjithashtu ishin në dijeni se të ndaluarit nuk po merrnin pjesë aktive në luftime për shkak se ishin të ndaluar.

102. Pasi ka shqyrtuar materialin mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e përmendura më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që ekziston dyshimi i bazuar mirë se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u krye krimi i luftës i ndalimit arbitrar sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit në lidhje me të paktën gjashtë të ndaluar.

¹⁸⁵ [E REDAKTUAR].

¹⁸⁶ [E REDAKTUAR].

¹⁸⁷ [E REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* para. 113 (Pika 3: Tortura).

¹⁸⁸ [E REDAKTUAR].

¹⁸⁹ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁰ *Shih më lart* para. 95-97, 99 (Pika 1), para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

2. Pika 2: Trajtimi mizor si krim lufte

103. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u krye trajtimi mizor i të paktën gjashtë të ndaluarve, që përbën krim lufte sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.¹⁹¹

104. Për sa u përket elementëve materialë të krimit, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që materiali mbështetës tregon se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, anëtarë të UÇK-së u shkakuan lëndime dhe vuajtje të rënda fizike dhe psikologjike të paktën gjashtë të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash. Kushtet e ndalimit ishin krejtësisht të papërshtatshme. Të ndaluarve iu hoq liria pa proces të rregullt ligjor.¹⁹² Ata mbaheshin në një stallë bagëtish, me sanë të shtruar mbi tokë, pa dritare të përshtatshme apo dritë natyrore.¹⁹³ Ushqimi dhe uji ishin të pamjaftueshëm dhe nuk u jepeshin rregullisht,¹⁹⁴ aq sa kur u liruan, këta të ndaluar nuk pushonin dot së ngrëni.¹⁹⁵ Të ndaluarit ishin të detyruar të flinin përdhe, mbi pellgje uji dhe në të ftohtë.¹⁹⁶ Ata nuk kishin banjë apo ujë të rrjedhshëm dhe duhej t'i kryenin nevojat në një kovë brenda në stallë.¹⁹⁷ Jo vetëm që nuk kishte kujdes mjekësor, por të ndaluarit rriheshin nëse kërkonin mjek.¹⁹⁸

105. Të ndaluarit në fjalë rriheshin pothuaj përditë, ndonjëherë dy herë në ditë, si në dhomën ku mbaheshin, ashtu edhe në një dhomë tjetër në katin e sipërm.¹⁹⁹ Të paktën në një rast, një të ndaluar iu vendos një thes i zi mbi kokë dhe u godit me grusht [E REDAKTUAR], duke i shkakuar gjakderdhje nga goja.²⁰⁰ Rrahjet ndodhnin sapo

¹⁹¹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 21-22, 35.

¹⁹² *Shih më lart*, para. 95-97 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

¹⁹³ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁴ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁵ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁶ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁷ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁸ [E REDAKTUAR].

¹⁹⁹ [E REDAKTUAR].

²⁰⁰ [E REDAKTUAR].

të ndaluarit arrinin në kompleksin e ndalimit në Zllash, ose pak më pas.²⁰¹ Materiali mbështetës tregon se të paktën në një rast, anëtarë të UÇK-së rrahën dhe shkëmbuan me radhë një të ndaluar në të gjithë trupin, duke përdorur ndër të tjera edhe një shkop druri, [E REDAKTUAR].²⁰² Prej stallës ku mbaheshin, të ndaluarit mund të dëgjonin britmat e të ndaluarve të tjerë ndërkohë që i rrihnin në katin e sipërm para se t'i sillnin përsëri në stallë.²⁰³ Materiali mbështetës tregon se përveç rrahjeve, anëtarë të UÇK-së: (i) u lidhnin të ndaluarve tela elektrikë në këmbë dhe u lëshonin rrymë;²⁰⁴ (ii) i zhvishnin dhe u pikonin dyllë të nxehtë nga qirinj për t'u djegur pjesë të trupit;²⁰⁵ (iii) në të paktën dy raste mbajtën një hekur të nxehtë mbi trupat e të ndaluarve;²⁰⁶ (iv) iu dogjën pjesë të trupit me një shufër metali të nxehtë;²⁰⁷ (v) shkaktuan prerje me thika;²⁰⁸ dhe (vi) urinuan mbi të ndaluarit.²⁰⁹

106. Në veçanti, materiali mbështetës thekson tri incidente në të cilat z. Mustafa ishte pjesëmarrës. Në një rast, më 1 prill 1999 ose rreth asaj date, z. Mustafa, i cili iu prezantua të ndaluarve si komandant Cali,²¹⁰ rrahu një të ndaluar dhe më pas urdhëroi edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së që ta rrihnin.²¹¹ Në një rast tjetër, gjithashtu më 1 prill 1999 ose rreth asaj date, z. Mustafa rrahu një të ndaluar dhe urdhëroi edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së që ta rrihnin;²¹² nga fundi i rrahjes, z. Mustafa [E REDAKTUAR].²¹³ Afërsisht dhjetë ditë më vonë, z. Mustafa e rrahu [E REDAKTUAR] në prani të tre ose katër anëtarëve të tjerë të UÇK-së.²¹⁴

²⁰¹ [E REDAKTUAR].

²⁰² [E REDAKTUAR].

²⁰³ [E REDAKTUAR].

²⁰⁴ [E REDAKTUAR].

²⁰⁵ [E REDAKTUAR].

²⁰⁶ [E REDAKTUAR].

²⁰⁷ [E REDAKTUAR].

²⁰⁸ [E REDAKTUAR].

²⁰⁹ [E REDAKTUAR].

²¹⁰ [E REDAKTUAR].

²¹¹ [E REDAKTUAR].

²¹² [E REDAKTUAR].

²¹³ [E REDAKTUAR].

²¹⁴ [E REDAKTUAR].

107. Për sa i përket shkallës së dëmtimit ose lëndimit të shkaktuar, materiali mbështetës tregon se si pasojë e keqtrajtimit gjatë mbajtjes së tyre të mbyllur në kompleksin e ndalimit në Zllash, të ndaluarit pësuan lëndime fizike, si thyerje krahësh, gishtash dhe dhëmbësh,²¹⁵ si dhe trauma psikologjike.²¹⁶ Pas disa prej rrahjeve, të ndaluarit humbën vetëdijen.²¹⁷ Kur u liruan, të ndaluarit ishin në gjendje të rëndë, me tesha të shqyera, thonj të gjatë, të parruar, me shenja në trup dhe [E REDAKTUAR].²¹⁸

108. Në lidhje me elementin mendor të krimit, materiali mbështetës tregon mospajtimin e kushteve njerëzore të ndalimit, mënyrën e qëllimshme se si u rrahën dhe keqtrajtuat të ndaluarit, llojet e mjeteve të përdorura në keqtrajtimet fizike dhe lëndimet e shkaktuara. Kjo tregon se z. Mustafa, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, duke marrë pjesë në veprimet dhe mosveprimet e sipërpërmendura, kishin synimin t'u shkaktonin vuajtje dhe lëndime të rënda mendore dhe fizike ose t'u cenonin rëndë dinjitetin të ndaluarve në fjalë.²¹⁹

109. Së fundi, për sa i përket statusit të mbrojtur të viktimave, lidhjes me konfliktin dhe dijenisë së kryesve për rrethanat faktike që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve në lidhje me Pikën 1 më lart.²²⁰

110. Pasi ka shqyrtuar materialin mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e përmendura më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshimi i bazuar mirë se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u krye krimi i luftës i trajtimit mizor brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, në lidhje me të paktën gjashtë të ndaluar.

²¹⁵ [E REDAKTUAR].

²¹⁶ [E REDAKTUAR].

²¹⁷ [E REDAKTUAR].

²¹⁸ [E REDAKTUAR].

²¹⁹ [E REDAKTUAR].

²²⁰ *Shih më lart* para. 98, 100-101 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

3. Pika 3: Tortura si krim lufte

111. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u ushtrua torturë ndaj të paktën gjashtë të ndaluarve, që përbën krim lufte sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.²²¹

112. Për sa u përket elementëve materialë të krimit, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që materiali mbështetës tregon se përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në lidhje me trajtimin mizor (Pika 2) më lart, z. Mustafa, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, u shkaktuan dhimbje ose vuajtje të rënda të paktën gjashtë të ndaluarve.

113. Në lidhje me elementin mendor të krimit, materiali mbështetës tregon mënyrën e qëllimshme se si u rrahën dhe keqtrajtuat të ndaluarit, llojet e mjeteve të përdorura në keqtrajtimet fizike, kërcënimet me lëndim dhe vdekje, dhe lëndimet e shkaktuara. Në veçanti, materiali mbështetës tregon se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, gjatë kohës që keqtrajtoheshin, të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u morën në pyetje dhe u akuzuan hapur se bashkëpunonin dhe shoqëroheshin me serbë, ose se ishin spiunë apo vjedhës.²²² Gjatë një marrjeje në pyetje, z. Mustafa personalisht i kërkoi një të ndaluarit [E REDAKTUAR]. [E REDAKTUAR].²²³ Gjatë një marrjeje në pyetje [E REDAKTUAR] në një rast të mëhershëm, z. Mustafa e kërcënoi atë se do ta vriste, [E REDAKTUAR].²²⁴ Në një rast tjetër, z. Mustafa e pyeti një të ndaluar për arsyen pse [E REDAKTUAR].²²⁵ [E REDAKTUAR], z. Mustafa e akuzoi se [E REDAKTUAR], e qëllloi me shuplakë dhe e shkëlmoi.²²⁶ Kjo tregon se z. Mustafa,

²²¹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 29, 35.

²²² [E REDAKTUAR].

²²³ [E REDAKTUAR].

²²⁴ [E REDAKTUAR].

²²⁵ [E REDAKTUAR].

²²⁶ [E REDAKTUAR].

së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së, duke marrë pjesë në veprimet dhe mosveprimet e sipërpërmendura, kishin synimin t'u shkaktonin vuajtje dhe lëndime të rënda të ndaluarve në fjalë, për të marrë prej tyre informata ose deklarata pranuese, për t'i ndëshkuar, frikësuar ose shtrënguar.

114. Së fundi, për sa i përket statusit të mbrojtur të viktimave, lidhjes me konfliktin dhe dijenisë së kryesve për rrethanat faktike që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimave, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve në lidhje me Pikën 1 më lart.²²⁷

115. Pasi ka shqyrtuar materialin mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e përmendura më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që ekziston dyshimi i bazuar mirë se afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u krye krimi i luftës i torturës brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, në lidhje me të paktën gjashtë të ndaluar.

4. Pika 4: Vrasja e paligjshme si krim lufte

116. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se një nga të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash u vra në një datë midis 19 prillit 1999 ose rreth kësaj date dhe afërsisht fundit të prillit 1999, që përbën krimin e luftës të vrasjes së paligjshme sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit.²²⁸

117. Për sa u përket elementëve materialë të krimit, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që materiali mbështetës tregon se gjatë gjithë kornizës kohore të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, viktima u mbajt në kompleksin e ndalimit në Zllash [E REDAKTUAR].²²⁹ Më konkretisht, materiali mbështetës tregon

²²⁷ *Shih më lart* para. 98, 100-101 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²²⁸ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 31-32, 35.

²²⁹ [E REDAKTUAR].

se ai [E REDAKTUAR]²³⁰ dhe se [E REDAKTUAR]²³¹ në atë masë sa nuk ishte në gjendje [E REDAKTUAR].²³² Viktima u dogj me një shufër metali të nxehtë²³³ si edhe me një hekur të nxehtë²³⁴, iu lëshua rrymë përmes telave elektrikë që iu vunë në trup,²³⁵ kishte shenja prerjesh me thikë²³⁶ dhe ishte i mbuluar në gjak pas çdo seance të marrjes në pyetje.²³⁷ Gjatë kohës që viktima ishte i ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash në prill 1999, familja e tij u përpoq të mblidhte informacion për vendin ku ndodhej dhe për gjendjen e tij, por u ishte thënë se [E REDAKTUAR] mund [E REDAKTUAR]²³⁸ [E REDAKTUAR].²³⁹ Ndërsa disa të ndaluar u liruan më 19 prill 1999, ose rreth kësaj date, [E REDAKTUAR]. Ai nuk ishte në gjendje të qëndronte në këmbë.²⁴⁰ Kufoma e tij u zbulua [E REDAKTUAR], në [E REDAKTUAR].²⁴¹ [E REDAKTUAR].²⁴² [E REDAKTUAR].²⁴³ Në trup kishte një vrimë plumbi në shpinë dhe shenja të keqtrajtimit, ndër të cilat të dy këmbët e thyera dhe plagë në të gjithë trupin.²⁴⁴

118. Në lidhje me elementin mendor të krimit, materiali mbështetës tregon mënyrën e qëllimshme se si viktima u keqtrajtua dhe qëllua me armë zjarri, shkallën e dhunës dhe llojet e mjeteve të përdorura në dhunën e ushtruar fizike, si dhe lëndimet e shkaktuara, përfshirë edhe vrimën e plumbit në shpinë. [E REDAKTUAR] disa

²³⁰ [E REDAKTUAR].

²³¹ [E REDAKTUAR].

²³² [E REDAKTUAR].

²³³ [E REDAKTUAR].

²³⁴ [E REDAKTUAR].

²³⁵ [E REDAKTUAR].

²³⁶ [E REDAKTUAR].

²³⁷ [E REDAKTUAR].

²³⁸ [E REDAKTUAR].

²³⁹ [E REDAKTUAR].

²⁴⁰ [E REDAKTUAR].

²⁴¹ [E REDAKTUAR]. *Shih gjithashtu* [E REDAKTUAR]; [E REDAKTUAR]; SPOE00128266-00128273, f. 1 (SPOE00128266), f. 5-6 (SPOE00128270-SPOE00128271), ku tregohen koordinatat dhe vendndodhjet përkatëse të kompleksit të ndalimit në Zllash [E REDAKTUAR].

²⁴² [E REDAKTUAR].

²⁴³ [E REDAKTUAR].

²⁴⁴ [E REDAKTUAR].

anëtarëve të familjes së viktimës [E REDAKTUAR].²⁴⁵ Kjo dëshmon se z. Mustafa dhe anëtarët e tjerë të UÇK-së, duke marrë pjesë në veprimet dhe mosveprimet e sipërpërmendura, kishin synimin të vrisnin ose të paktën shkaktuan qëllimisht lëndim të rëndë ose dëmtim të rëndë fizik që logjikisht duhej ta kishin ditur se mund të çonte në vdekjen e të ndaluarit.

119. Së fundi, për sa i përket statusit të mbrojtur të viktimës, lidhjes me konfliktin dhe dijenisë së kryesve për rrethanat faktike që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit të armatosur dhe statusin e viktimës, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve në lidhje me Pikën 1 më lart.²⁴⁶

120. Pasi ka shqyrtuar materialin mbështetës në tërësi në lidhje me kriteret e përmendura më lart, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që ekziston dyshimi i bazuar mirë se në një datë afërsisht midis ose rreth 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në kompleksin e ndalimit në Zllash u krye krimi i luftës i vrasjes së paligjshme brenda kuptimit të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, në lidhje me një të ndaluar.

C. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE NË AKTAKUZË

1. Kryerja e drejtpërdrejtë

121. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa kreu fizikisht krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.²⁴⁷

²⁴⁵ [E REDAKTUAR].

²⁴⁶ *Shih më lart* para. 98, 100-101 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁴⁷ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 34-35.

122. Në lidhje me elementët objektivë²⁴⁸ dhe subjektivë²⁴⁹ të kryerjes fizike prej z. Mustafa të krimit të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve të mësipërme në Pikat 1-3.

123. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa kreu fizikisht krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

2. Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I

124. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja parashtron se z. Mustafa, si anëtar i një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, kreu krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3), dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.²⁵⁰

125. Në lidhje me elementët objektivë të kësaj forme të përgjegjësisë penale, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se materiali mbështetës tregon se një shumësi personash ndër të cilët edhe z. Mustafa u përfshinë në funksionimin e kompleksit të ndalimit në Zllash dhe në keqtrajtimin e të ndaluarve të mbajtur atje. Në veçanti, anëtarë të UÇK-së si z. Mustafa, “Tabuti” ose “komandant Tabuti”, “Ilmi Vela”, “Bimi”, “Dardani”, “Afrimi” dhe ushtarë, policë e roja të tjerë të UÇK-së morën pjesë në ndalimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve.²⁵¹

126. Materiali mbështetës tregon më tej se gjatë kohës që ka lidhje me akuzat, individët e lartpërmendur kishin qëllim të përbashkët marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve. Qëllimi i përbashkët përfshinte kryerjen e krimeve të

²⁴⁸ *Shih më lart* para. 95-97 (Pika 1), para. 104-107 (Pika 2), para. 112 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁴⁹ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 108 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁵⁰ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 7-10, 34-35.

²⁵¹ [E REDAKTUAR].

ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme. Në veçanti, veprimet dhe mosveprimet e përshkruara në lidhje me Pikat 1-4 dëshmojnë se z. Mustafa dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së vepruan me qëllimin e përbashkët të ndalimit arbitrar, keqtrajtimit të egër, marrjes në pyetje dhe shkaktimit të qëllimshëm të lëndimeve të rënda fizike që çuan në vdekje, dhe të vrasjes së të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash.²⁵²

127. Kontributi i qenësishëm i z. Mustafa në qëllimin e përbashkët duket prej veprimeve dhe mosveprimeve të tij përshkruar në lidhje me Pikat 1-4. Materiali mbështetës tregon se z. Mustafa, në cilësinë si komandant Cali,²⁵³ mori pjesë në planin e përbashkët ndër të tjera nëpërmjet: (i) komandimit të anëtarëve të tjerë të UÇK-së në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës së aktakuzës; (ii) pjesëmarrjes në kryerjen e krimeve të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3), dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4); (iii) urdhërimit të anëtarëve të tjerë të UÇK-së për kryerjen e krimeve të tilla; (iv) dhe lejimit e mbështetjes së këtyre krimeve me praninë e tij.²⁵⁴

128. Sa i përket elementit subjektiv të kësaj forme të përgjegjësisë penale, materialin mbështetës tregon se duke marrë pjesë aktive dhe në vijimësi në keqtrajtimin e të ndaluarve, ndër të tjera për marrjen e informatave dhe ndëshkimin e tyre, si dhe duke mos marrë masa për lirimin e të ndaluarve dhe duke mos dhënë garancitë procedurale bazë, z. Mustafa kishte të njëjtin synim për kryerjen e krimeve të Pikave 1-4 që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së.²⁵⁵

²⁵² *Shih më lart* para. 95-97, 99 (Pika 1), para. 104-107 (Pika 2), para. 112-113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁵³ [E REDAKTUAR]; [E REDAKTUAR] (ku z. Mustafa pranon se njihej si komandant Cali dhe se mbante një beretë të kuqe).

²⁵⁴ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3), para. 117 (Pika 4). *Shih gjithashtu* para. 150 (Përgjegjësia eprorë) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁵⁵ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 108 (Pika 2), para. 113 (Pika 3), para. 118 (Pika 4) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

129. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se si anëtar i NKP-së z. Mustafa kreu krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4) brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

3. Ndërmarrje kriminale e përbashkët III

130. Si alternativë ndaj përgjegjësisë së pretenduar të z. Mustafa sipas Pikës 4 përmes kontributit të qenësishëm në NKP, në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë ZPS-ja pretendon se z. Mustafa kreu krimin e luftës të vrasjes së paligjshme sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, sepse për të ishte e parashikueshme që ky krim ishte pasojë e mundshme e zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe ai e mori përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë.²⁵⁶

131. Gjykatësi i procedurës paraprake e shqyrton këtë formë të përgjegjësisë penale si alternativë, në rast se krimi i vrasjes së paligjshme (Pika 4) ishte jashtë qëllimit të përbashkët të NKP-së së lartpërmendur. Rrjedhimisht, në lidhje me elementët objektivë të kësaj forme përgjegjësie penale, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve të lartpërmendura: se z. Mustafa ishte anëtar i një NKP-je qëllimi i përbashkët i së cilës përfshinte kryerjen e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës.²⁵⁷ Gjithashtu urdhrat e mëhershëm të z. Mustafa për keqtrajtim, kushtet e vështira të ndalimit dhe ushtrimi i dhunës së rëndë fizike dhe psikologjike kundër të ndaluarve për një periudhë të zgjatur e bënë vdekjen [E REDAKTUAR] pasojë objektivisht të parashikueshme të zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së.

132. Lidhur me elementin subjektiv të kësaj forme të përgjegjësisë penale, materiali mbështetës tregon se z. Mustafa kishte synim të merrte pjesë dhe të kontribuonte në

²⁵⁶ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 8.

²⁵⁷ *Shih më lart* para. 125-126 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

realizimin e qëllimit të përbashkët.²⁵⁸ Gjithashtu, materiali mbështetës tregon se z. Mustafa si oficer komandues, ishte në dijeni se gjatë ndalimit viktima ishte [E REDAKTUAR]²⁵⁹ në atë masë sa që pas çdo marrjeje në pyetje ishte i mbuluar në gjak²⁶⁰ dhe nuk ishte më në gjendje [E REDAKTUAR].²⁶¹ Për më tepër, z. Mustafa ishte në dijeni të kushteve çnjerëzore, ndër të cilat mungesa e shërbimit mjekësor, në të cilat u mbajt [E REDAKTUAR] së bashku me të ndaluarit e tjerë.²⁶² Më tej, fakti se z. Mustafa mori përsipër me vullnet të lirë rrezikun se [E REDAKTUAR] mund të vritej, mund të deduktohet nga mënyra e qëllimshme se si u keqtrajtua viktima, si edhe nga kushtet e ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash.²⁶³

133. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se si alternativë ndaj përgjegjësisë penale të pretenduar të z. Mustafa për të njëjtin krim sipas NKP I, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa, si anëtar i NKP-së kreu krimin e luftës të vrasjes së paligjshme (Pika 4), duke qenë i vetëdijshëm për gjasën e kryerjes së këtij krimi gjatë zbatimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe duke e marrë përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë, brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

4. Urdhërimi

134. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa urdhëroi kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit.²⁶⁴

²⁵⁸ *Shih më lart* para. 128 (Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët I) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁵⁹ [E REDAKTUAR].

²⁶⁰ [E REDAKTUAR].

²⁶¹ *Shih më lart* para. 117 (Pika 4) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁶² *Shih më lart* para. 104 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁶³ *Shih më lart* para. 104-107 (Pika 2), para. 117 (Pika 4) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁶⁴ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 13, 34-35.

135. Në lidhje me elementët objektivë të kësaj forme të përgjegjesisë penale, materiali mbështetës tregon se z. Mustafa kishte pozitë pushteti *de jure* dhe *de facto* brenda strukturës së njësitit BIA, duke qenë se ai ishte i vetmi komandant që mbikëqyrte 10 deri në 15 njësite të përbërë nga pesë anëtarë të UÇK-së secili, dhe se ai i raportonte drejtpërsëdrejti Shtabit të Përgjithshëm.²⁶⁵ Të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash e njihnin z. Mustafa si komandant Cali.²⁶⁶

136. Materiali mbështetës tregon se z. Mustafa urdhëroi pjesëtarë të tjerë të UÇK-së që të ndalonin arbitrarisht dhe të keqtrajtonin egërsisht të ndaluarit dhe, gjatë zbatimit të këtyre urdhrave, anëtarët e UÇK-së ndaluan arbitrarisht, rrahën dhe keqtrajjuan fizikisht e psikologjikisht të ndaluarit në prani të z. Mustafa.²⁶⁷ Si rrjedhojë, materiali mbështetës tregon se urdhrat e z. Mustafa patën ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të lartpërmendura.

137. Lidhur me elementin subjektiv të kësaj forme të përgjegjesisë penale, materiali mbështetës tregon se për shkak të pushtetit të tij komandues dhe pjesëmarrjes së tij të drejtpërdrejtë në kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë,²⁶⁸ z. Mustafa kishte synimin e kryerjes së krimeve, ose së paku ishte i vetëdijshëm se krimet do të kryheshin gjatë zbatimit të veprimeve të urdhëruara.²⁶⁹

138. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa urdhëroi kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), brenda kuptimit të nenit 16(1)(a) të Ligjit.

²⁶⁵ [E REDAKTUAR].

²⁶⁶ [E REDAKTUAR]; [E REDAKTUAR] (ku z. Mustafa pranon se njëjaj si komandant Cali dhe se mbante një beretë të kuqe). *Shih gjithashtu më lart* para. 101 (Pika 1: Ndalim arbitrar), para. 106 (Pika 2: Trajtim mizor).

²⁶⁷ [E REDAKTUAR].

²⁶⁸ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁶⁹ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 108 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese. *Shih gjithashtu* [E REDAKTUAR].

5. Nxitja

139. Në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa nxiti krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), sipas nenit16(1)(a)të Ligjit.²⁷⁰

140. Sa u përket elementëve objektivë dhe subjektivë, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve në lidhje me format e përgjegjesisë penale të kryerjes së drejtpërdrejtë dhe urdhërimit.²⁷¹

141. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton që ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa nxiti kryerjen e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2) dhe torturës (Pika 3), brenda kuptimit të nenit 16(1)(a)të Ligjit.

6. Ndhimja dhe inkurajimi

142. Gjithashtu, dhe si alternativë ndaj përgjegjesisë së pretenduar për kryerje krimi, në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë ZPS-ja pretendon se z. Mustafa është penalisht përgjegjës për ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), sipas nenit16(1)(a)të Ligjit.²⁷²

143. Në lidhje me elementët objektivë të kësaj forme të përgjegjesisë penale, materiali mbështetës tregon se veprimet dhe mosveprimet e z. Mustafa përbënin ndihmë praktike, inkurajim ose mbështetje morale për kryerjen e krimeve të lartpërmendura. Në veçanti, z. Mustafa: (i) ishte i pranishëm aty ku mbaheshin dhe keqtrajtoheshin të

²⁷⁰ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 13, 34-35.

²⁷¹ *Shih më lart* para. 122 (Kryerja e drejtpërdrejtë), para. 136-137 (Urdhërimi) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁷² Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 34-35.

ndaluarit;²⁷³ (ii) nuk zbatoi procedurat e duhura të ndalimit;²⁷⁴ (iii) nuk mori masa të mjaftueshme për të siguruar kushte njerëzore të ndalimit në kompleksin e ndalimit në Zllash;²⁷⁵ dhe (iv) mori pjesë dhe ndihmoi kryesit e tjerë në keqtrajtimin që iu bë rregullisht disa të ndaluarve, ndër të tjera edhe gjatë marrjeve në pyetje.²⁷⁶ Materiali mbështetës tregon gjithashtu se kontributi i z. Mustafa pati ndikim të konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të lartpërmendura. Në veçanti, pozita e z. Mustafa si komandant inkurajoi anëtarë të tjerë të UÇK-së që të kryenin krimet dhe i legjitimoi ato.²⁷⁷ Po kështu, pjesëmarrja dhe ndihma e tij në keqtrajtime dhe shkalla e dhunës së ushtruar mbi të ndaluarit²⁷⁸ kontribuuan konsiderueshëm në kryerjen e krimeve të lartpërmendura.

144. Në lidhje me elementin subjektiv të kësaj forme të përgjegjësisë penale, materiali mbështetës tregon mënyrën e qëllimshme me të cilën z. Mustafa u përfshi në kryerjen e krimeve, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet inkurajimit të vartësve për t'i kryer ato, praninë e tij në dhomat e marrjes në pyetje dhe pjesëmarrjes së tij në vijimësi në keqtrajtimin e të ndaluarve.²⁷⁹ Kjo dëshmon që z. Mustafa e dinte se veprimet dhe mosveprimet e tij ndihmuan në kryerjen e krimeve të lartpërmendura nga anëtarë e tjerë të UÇK-së dhe se ai ishte në dijeni të elementëve thelbësorë të krimeve që u kryen.

145. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se, si alternativë ndaj përgjegjësisë penale të pretenduar të z. Mustafa për kryerje të krimit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Mustafa ndihmoi dhe inkurajoi krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2),

²⁷³ *Shih më lart* para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese. *Shih gjithashtu* [E REDAKTUAR].

²⁷⁴ *Shih më lart* para. 95-97 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁷⁵ *Shih më lart* para. 104-107 (Pika 2), para. 112-113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁷⁶ *Shih më lart* para. 104-107 (Pika 2), para. 112-113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁷⁷ *Shih më lart* para. 106 (Pika 2: Trajtimi mizor), para. 113 (Pika 3: Tortura).

²⁷⁸ *Shih më lart* para. 104-107 (Pika 2), para. 112-113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁷⁹ *Shih më lart* para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), brenda kuptimit të nenit 16(1)(a)të Ligjit.

7. Përgjegjësia eprorë

146. Më tej, dhe si alternativë ndaj formave të përgjegjësive penale sipas nenit 16(1)(a)të Ligjit, në Aktakuzën e Rishikuar për Herë të Dytë ZPS-ja pretendon se z. Mustafa është penalisht përgjegjës si epror për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), sipas nenit 16(1)(c)të Ligjit.²⁸⁰

147. Sa i përket marrëdhënies epror-vartës, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve lidhur me pozitën e z. Mustafa si komandant brenda strukturës së njësitit BIA.²⁸¹ Z. Mustafa, si komandanti i vetëm i njësitit BIA, i raportonte drejtpërsëdrejti Shtabit të Përgjithshëm dhe kishte pushtet efektiv mbi ushtarët e tij dhe të nënnjësiteve të BIA-s, duke përfshirë edhe lidhur me disiplinën.²⁸² Gjithashtu, z. Mustafa kishte edhe një zëvendës që e ndihmonte,²⁸³ i cili ishte i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash gjatë periudhës përkatëse.²⁸⁴ Kjo tregon se z. Mustafa kishte aftësinë materiale t'i parandalonte dhe t'i ndëshkonte vartësit e tij në kohën e kryerjes së krimeve. Bazuar në sa më lart, rrjedh që gjatë periudhës përkatëse që lidhet me akuzat, ekzistonte marrëdhënie epror-vartës ndërmjet z. Mustafa, si komandant i njësitit BIA, dhe anëtarëve të UÇK-së në kompleksin e ndalimit në Zllash.

²⁸⁰ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, para. 14-17, 34-35.

²⁸¹ *Shih më lart* para. 101 (Pika 1), para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese. *Shih gjithashtu* para. 135 (Urdhërimi).

²⁸² [E REDAKTUAR].

²⁸³ [E REDAKTUAR].

²⁸⁴ [E REDAKTUAR].

148. Sa u përket krimeve të kryera, gjykatësi i procedurës paraprake u referohet konstatimeve të tij lidhur me krimet e ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), të kryera nga vartësit e z. Mustafa.²⁸⁵

149. Për sa i përket njohurisë së z. Mustafa, materiali mbështetës tregon se gjatë periudhës përkatëse të akuzave, ai udhëzoi vartësit e tij të kryenin krime, ishte i pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe gjithashtu mori pjesë aktivisht në kryerjen e tyre.²⁸⁶ Kjo dëshmon se z. Mustafa, në rrethanat konkrete të asaj kohe, jo vetëm që dinte për krimet e kryera, por edhe dispononte informacion mjaftueshmërisht alarmues që e vinte në dijeni të krimeve dhe që përlligjte kryerjen e hetimeve të mëtejshme. Nga kjo rrjedh që z. Mustafa dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së krimeve të ngritura në aktakuzë, ose i kishin kryer ato.

150. Në lidhje me mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej z. Mustafa, materiali mbështetës tregon se në cilësinë e tij si komandant brenda strukturës së njësitit BIA, z. Mustafa kishte detyrën e parandalimit të kryerjes së krimeve në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe detyrën e ndëshkimit të vartësve të tij për krimet e kryera gjatë periudhës që lidhet me akuzat.²⁸⁷ Megjithatë, z. Mustafa nuk mori asnjë masë të nevojshme dhe të arsyeshme në përmbushje të detyrave të tij si komandant. Në veçanti, ndonëse z. Mustafa duhej të informohej për shkeljet e ushtarëve të njësitit BIA dhe kishte kompetencë të merrte masa disiplinore kundër vartësve të tij,²⁸⁸ në materialin mbështetës nuk ka asgjë që të tregojë se ai mori ndonjë masë për të parandaluar ose ndëshkuar kryesit e krimeve të përfshira në aktakuzë. Materiali mbështetës sugjeron se z. Mustafa në asnjë moment nuk synonte t'i lironte

²⁸⁵ *Shih më lart* para. 95-97 (Pika 1), para. 104-105, 107 (Pika 2), para. 112-113 (Pika 3), para. 117 (Pika 4) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁸⁶ *Shih më lart* para. 99 (Pika 1), para. 106 (Pika 2), para. 113 (Pika 3) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁸⁷ *Shih më lart* para. 147 (Përgjegjësia eprore) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁸⁸ [E REDAKTUAR].

të ndaluarit, t'u jepte atyre ndonjë garanci bazë, ose ndryshe t'i jepte fund keqtrajtimit, duke përfshirë edhe keqtrajtimin e të ndaluarit që humbi jetën.²⁸⁹ Në fakt, të ndaluarit u liruan papritur vetëm kur forcat serbe iu afruan kompleksit të ndalimit në Zllash dhe forcat e UÇK-së u përgatitën për tërheqje.²⁹⁰

151. Pas shqyrtimit të materialit mbështetës në tërësi, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se, si alternativë ndaj formave të përgjegjësisë sipas nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Mustafa është penalisht përgjegjës si epror për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4), brenda kuptimit të nenit 16(1)(c) të Ligjit.

VII. CILËSIMI LIGJOR I AKUZAVE

152. ZPS-ja e akuzon z. Mustafa për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme sipas nenit 14 të Ligjit dhe nenit 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, të përfshirë në nenet 15(1)(a) dhe 16(2) të Ligjit.²⁹¹

153. Gjykatësi i procedurës paraprake vëren se neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së përcakton se, ndër shkelje të tjera "të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohë lufte, konflikti të armatosur ose pushtimi", vrasjet, tortura, trajtimi çnjerëzor si dhe arrestimet dhe ndalimi i paligjshëm, janë të dënueshme si krime lufte kundër popullatës civile. Duke qenë se neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së përfshin përmes referimit dispozitat e së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme gjatë konflikteve të armatosura, elementët përbërës të krimeve të akuzuara sipas nenit 142 përputhen me ato të identifikuara më lart sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit.

²⁸⁹ *Shih më lart* para. 97 (Pika 1) dhe poshtëshënimet shoqëruese.

²⁹⁰ [E REDAKTUAR].

²⁹¹ Aktakuza e Rishikuar për Herë të Dytë, f. 1 (Hyrje), para. 35.

154. Për këto arsye dhe duke pasur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Ligjin si *lex specialis*,²⁹² gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se neni 14(1)(c) i Ligjit është baza ligjore parësore dhe e përshtatshme për krimet e paraqitura në aktakuzë.

VIII. KËRKESA PËR RUAJTJEN E KONFIDENCIALITETIT

155. Përgjithësisht, rregulla 88(1) e Rregullores përcakton që aktakuza bëhet publike pas konfirmimit të saj. Më tej, sipas rregullave 95(1) dhe (2)(b) dhe 102(1)(a) të Rregullores, nxjerrja e materialeve, përfshirë edhe nxjerrjen e emrave të dëshmitarëve dhe viktimave, kryhet pas paraqitjes së parë të të akuzuarit në lidhje me të cilin është konfirmuar aktakuzë. Megjithatë, në rrethana të posaçme, sipas rregullave 88(2) dhe 105(1) të Rregullores, ZPS-ja mund të bëjë kërkesë që mosnxjerrja e përkohshme e aktakuzës, dokumenteve shoqëruese të saj dhe identiteteve të viktimave dhe dëshmitarëve të vazhdojë pas konfirmimit të aktakuzës ose paraqitjes së parë të të akuzuarit, sipas rastit. Theksohet se masat në bazë të rregullës 105(1) janë të përkohshme dhe mundësojnë mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave të cënueshme deri në dorëzimin e kërkesës për masa mbrojtëse.

156. Në lidhje me rrezikun e arratisjes së të akuzuarit, gjykatësi i procedurës paraprake është i mendimit se (i) vënia në dijeni e z. Mustafa për akuzat e paraqitura në aktakuzën që do t'i dorëzohet, dhe për dënimet e mundshme;²⁹³ (ii) dijenia e tij për vendimet e fajësisë ndaj komandantëve të lartë të Zonës Operative të Llapit për krime të ngjashme, të raportuara publikisht;²⁹⁴

²⁹² Neni 3(2)(b) i Ligjit.

²⁹³ Parashtrimi Fillestar, para. 6.

²⁹⁴ Parashtrimi Fillestar, para. 6; Kosovë, Gjykata Themelore Prishtinë, *Prokurori k. R. Mustafës dhe të tjerëve*, P 448/2012, Aktgjykim, 7 qershor 2013.

(iii) punësimi i tij aktual [E REDAKTUAR] në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës;²⁹⁵ dhe (iv) aftësia për të udhëtuar lirisht në vende ku nuk kërkohet vizë udhëtimi, tregojnë se ai ka motivin dhe mjetet për t'u arratisur.²⁹⁶ Për më tepër, gjykatësi i procedurës paraprake vë në dukje parashtrimet e bëra nga ZPS-ja në lidhje me mungesën e kushteve fizike ose shëndetësore apo të obligimeve familjare që ta mbajnë atë të lidhur me vendbanimin e tij.²⁹⁷

157. Për sa i përket ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, gjykatësi i procedurës paraprake është i mendimit se [E REDAKTUAR].²⁹⁸ [E REDAKTUAR].²⁹⁹ Gjithashtu, disa dëshmitarë dhe viktimë [E REDAKTUAR].³⁰⁰ [E REDAKTUAR].³⁰¹ Për më tepër, sipas ZPS-së, procesi gjyqësor kundër eprorit të drejtpërdrejtë të z. Mustafa është dëmtuar nga frikësimi i dëshmitarëve.³⁰² Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake nxjerr përfundimin se z. Mustafa ka motivin, mjetet, dhe mundësinë të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave dhe, për pasojë, të pengojë përparimin e procedimit penal.

158. Në lidhje me kryerjen e krimeve të mëtejshme, gjykatësi i procedurës paraprake vëren gjithashtu se i dyshuari është mburrur publikisht për ekzekutimin e serbëve, çka tregon për rrezikun e mëtejshëm se ai mund të përdorë dhunën fizike ose kërcënimin e dhunës fizike ndaj viktimave dhe dëshmitarëve.³⁰³

159. Bazuar në faktorët e renditur në paragrafët 156-158, gjykatësi i procedurës paraprake konstaton se ZPS-ja ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme që përlligjin rrethanat e veçanta të cilat, në bazë të rregullës 88(2) të Rregullores,

²⁹⁵ Parashtrimi Fillestar, para. 7; [E REDAKTUAR].

²⁹⁶ Parashtrimi Fillestar, para. 7.

²⁹⁷ Parashtrimi Fillestar, para. 7.

²⁹⁸ Parashtrimi Fillestar, para. 10.

²⁹⁹ Parashtrimi Fillestar, para. 11; [E REDAKTUAR].

³⁰⁰ Parashtrimi Fillestar, para. 10.

³⁰¹ Parashtrimi Fillestar, para. 10.

³⁰² Parashtrimi Fillestar, para. 9.

³⁰³ Parashtrimi Fillestar, para. 12; [E REDAKTUAR].

lejojnë mosnxjerrjen e përkohshme të: (i) aktakuzës, sikurse është konfirmuar (“Aktakuza e Konfirmuar”); dhe (ii) Parashtrimin Fillestar me shtojcat e tij, Parashtrimin të Dytë me shtojcat e tij, dhe Parashtrimin të Tretë me shtojcën e tij (“dokumente shoqëruese”).

160. Bazuar në faktorët e renditur në paragrafët 157 dhe 158, gjykatësi i procedurës paraprake gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka treguar se ekzistojnë rrethana të veçanta sipas rregullës 105(1) të Rregullores që përlligjin mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave, deri sa të jenë urdhëruar masa mbrojtëse të përshtatshme.

161. Si rrjedhojë, mosnxjerrja e Aktakuzës së Konfirmuar për publikun³⁰⁴ do të zbatohet deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprake, por jo më vonë se paraqitja e parë e të akuzuarit, sikurse parashihet në rregullën 88(2) të Rregullores. Të akuzuarit i dorëzohet Aktakuza e Konfirmuar rreptësisht konfidenciale me redaktimet e nevojshme, në bazë të rregullave 87(1) dhe 105(1) të Rregullores. Pavarësisht nga konfidencialiteti i Aktakuzës së Konfirmuar, në pajtim me rregullën 88(3) të Rregullores, ZPS-ja mund t’ua bëjë të njohur aktakuzën (e redaktuar) ose pjesë të saj, autoriteteve të Kosovës, të një shteti të tretë apo subjekti tjetër, në qoftë se e gjykon të nevojshme për hetime ose ndjekje penale.

162. Gjithashtu, mosnxjerrja e dokumenteve shoqëruese dhe materialit mbështetës të Aktakuzës së Konfirmuar zbatohet deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprake, sikurse parashihet në rregullën 88(2) të Rregullores. Megjithatë, materiali mbështetës me redaktimet e nevojshme i vihet

³⁰⁴ Në kuadër të këtij vendimi, me ‘publik’ nënkuptohen të gjithë personat, organizatat, subjektet, shtetet e treta, klientët, shoqatat dhe grupet, duke përfshirë mediat, me përjashtim të gjykatësve të Dhomave të Specializuara (dhe stafit të tyre), Zyrës Administrative, ZPS-së, dhe të akuzuarit, Salih Mustafa.

në dispozicion të akuzuarit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e tij e parë, sipas rregullave 102(1)(a) dhe 105(1) të Rregullores.

IX. VENDIM

163. Bazuar në sa më lart, gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. **KONFIRMON** akuzat e ndalimit arbitrar (Pika 1), trajtimit mizor (Pika 2), torturës (Pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (Pika 4) kundër z. Mustafa, si krime lufte të ndëshkueshme sipas nenit 14(1)(c) dhe nenit 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit, sikurse përcaktohen në këtë vendim;
- b. **URDHËRON** Prokurorin e Specializuar që brenda një jave prej njoftimit të këtij vendimi, të dorëzojë një aktakuzë të mëtejshme të rishikuar në të cilën z. Mustafa të akuzohet vetëm sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit, e cila do të konsiderohet si “Aktakuza e Konfirmuar”;
- c. **AUTORIZON** ZPS-në të redaktojë emrat dhe informacionin identifikues të çdo viktime ose dëshmitari në Aktakuzën e Konfirmuar, dokumentet shoqëruese dhe materialin mbështetës si dhe të caktojë dhe të përdorë pseudonime të përkohshme për këta viktima dhe dëshmitarë;
- d. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë një version rreptësisht konfidencial dhe të redaktuar të Aktakuzës së Konfirmuar brenda një jave prej njoftimit të këtij vendimi;
- e. **URDHËRON** Zyrën Administrative që, në këshillim me ZPS-në, t’i dorëzojë të akuzuarit versionin rreptësisht konfidencial dhe të redaktuar të Aktakuzës së Konfirmuar;
- f. **AUTORIZON** ZPS-në t’ua bëjë të njohur Aktakuzën e Konfirmuar rreptësisht konfidenciale dhe të redaktuar, ose pjesë të saj, autoriteteve të Kosovës, të një shteti të tretë ose subjekti tjetër, në qoftë se gjykohet e nevojshme për hetime ose ndjekje penale;

- g. **URDHËRON** mosnxjerrjen e dokumenteve shoqëruese dhe materialit mbështetës deri në një urdhër të mëtejshëm;
- h. **URDHËRON** mosnxjerrjen e Aktakuzës së Konfirmuar për publikun deri në një urdhër të mëtejshëm; dhe
- i. **URDHËRON** ZPS-në të paraqesë një kërkesë për masa mbrojtëse, nëse është e nevojshme, në lidhje me viktimat dhe dëshmitarët e identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar, dokumentet shoqëruese dhe materialin mbështetës brenda dy javësh prej paraqitjes së parë të të akuzuarit.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i procedurës paraprake

E hënë, 5 tetor 2020
Në Hagë, Holandë.